

SQ

DOKUMENT PRAKTIKE

**MARKA TREGTARE NË KUNDËRSHTIM
ME POLITIKËN PUBLIKE OSE ME
PARIMET E PRANUARA TE MORALIT**

**DREJTORIA E PERGJITHSHME E
PRONËSISË INDUSTRIALE (DPPI)
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Shënim nga Zyra e Pronësisë Industriale:

Ky Dokument Praktike është përgatitur në pajtim me Komunikimin e Përbashkët që rezulton nga Praktika e Përbashkët e Markave Tregtare e zhvilluar nga Rrjeti i Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Evropian (EUIPN) dhe synon të ofrojë një kuptim të koncepteve të politikave publike dhe të parimeve të pranuar të moralit, duke sqaruar marrëdhënien dhe dallimet ndërmjet këtyre dy koncepteve. Përveç kësaj, ky dokument përcakton kriteret për vlerësimin nëse një shenjë është në kundërshtim me politikat publike dhe/ose parimet e pranuar të moralit dhe jep shembuj ilustrues të kriterëve dhe të grupeve të shenjave të identifikuara.

Ky Dokument Praktike, i miratuar në nivel kombëtar, bëhet publik me qëllimin për të rritur më shumë transparencën, sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë si në dobi të ekzaminuesve, ashtu dhe të përdoruesve.

1. KONTEKSTI

Kjo Praktikë ofron një kuptim të koncepteve të politikave publike dhe të parimeve të pranuar të moralit, duke sqaruar marrëdhënien dhe dallimet ndërmjet këtyre dy koncepteve. Përveç kësaj, ky dokument përcakton kriteret për vlerësimin nëse një shenjë është në kundërshtim me politikat publike dhe/ose parimet e pranuar të moralit dhe jep shembuj ilustrues të kriterëve dhe të grupeve të shenjave të identifikuara.

Kjo Praktikë bëhet publike përmes këtij Dokumenti Praktike me qëllimin për të rritur më tej transparencën, sigurinë juridike dhe parashikueshmërinë në dobi si të ekzaminuesve, ashtu dhe të përdoruesve.

Ky Dokument Praktike parashtrohet një grup parimesh për mënyrën si vlerësohen politikat publike dhe parimet e pranuar të moralit në aplikimet për markat tregtare. Problematikat specifike që janë brenda dhe jashtë fushëveprimit të Praktikës detajohen në seksionin 1.3 dhe në një tabelë me konsideratat e përgjithshme, të cilat duhet të mbahen parasysh gjatë leximit të dokumentit. Përmbledhja e këtyre konsideratave të përgjithshme mund të gjendet këtu më poshtë:

- Të gjitha aplikimet duhet të vlerësohen **rast pas rasti** duke konsideruar nivelin normal të ndjeshmërisë dhe tolerancës së publikut përkatës brenda juridiksionit si dhe rrethanat specifike të Shqipërisë dhe të rastit konkret.
- Në rastet ku një shenjë është në kundërshtim **me politikat publike dhe parimet e pranuar të moralit të marra së bashku**, gjejmë zbatim kriteret e zbatueshme për secilën prej tyre.
- Duhet të merret parasysh **liria e shprehjes**. Megjithatë, ky Dokument Praktike nuk analizon mënyrën si duhet të kryhet vlerësimi. Shtojca për burimet e materialeve ligjore që trajtojnë lirinë e shprehjes është vënë në dispozicion vetëm për qëllime informacioni.
- Vlerësimi i nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të Direktivës për Markat Tregtare (DMT) mund të ketë një element **subjektiv**. Prandaj, ky nen duhet të zbatohet nga ekzaminuesit, të cilët bëjnë një deklaram objektive të arsyeve, aty ku është e mundur, duke përdorur burime të pavarura dhe të besueshme për të mbështetur vendimet e tyre.
- **Shembujt** e paraqitur në Dokumentin e Praktikës janë dhënë vetëm për qëllime të vlerësimit të nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së. Fakti që disa prej tyre mund të jenë të pranueshëm sipas kësaj dispozite nuk do të thotë se ato nuk mund të refuzohen për arsye të tjera. Të gjithë shembujt janë në anglisht dhe do të supozohet se ato do të kuptohen ashtu siç do t'i kuptonte një person që anglishten e ka gjuhë amtare.

Përveç kësaj, vihet në dukje se shembujt në dokument janë vetëm për qëllime ilustruese. Ata duhet të kuptohen se tregojnë zbatueshmërinë e disa parimeve të Dokumentit të Praktikës kur zbatohen në lidhje me publikun përkatës, i cili ka një nivel të caktuar ndjeshmërie dhe tolerance, dhe jo si përfundime imponuese se çfarë bie ndesh me politikat publike ose me parimet e pranuar të moralit në nivel kombëtar. Ata duhet të konsiderohen gjithmonë në lidhje me grupin përkatës dhe me parimin të cilit i referohen, duke mbajtur parasysh konsideratat e përgjithshme të përmendura më lart.

2. PRAKTIKA

Teksti i mëposhtëm përmbledh mesazhet kyçe dhe deklaratat kryesore të parimeve të Praktikës.

PARIMET E PRAKTIKËS

KUPTIMET

Kuptimet e politikave publike dhe të parimeve të pranuara të moralit

Seksioni i parë i Praktikës ravijëzon kuptimet e politikave publike dhe të parimeve të pranuara të moralit.

Politikat publike mund të kuptohen si *një grup normash, parimesh dhe vlerash themelore të shoqërive në Shqipëri dhe në Bashkimin Evropian në një pikë të caktuar në kohë. Në veçanti, ato përfshijnë vlerat universale të Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian si dinjiteti i njeriut, liria, barazia dhe solidariteti si dhe parimet e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, ashtu siç janë shpallur në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (KDTHE). Përmbajtja e tyre duhet të jetë e verifikueshme nga burime të besueshme dhe objektive. Për më shumë orientim, ky nënseksion përmban një listë joshteruese të elementëve të mëposhtëm: (1) tematikat që hyjnë në fushëveprimin e normave themelore; (2) parimet dhe vlerat themelore të Shqipërisë të cilat janë të përbashkëta për të gjitha Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian; dhe (3) shembuj të burimeve të besueshme dhe objektive nga të cilat duhet të verifikohen normat, parimet dhe vlerat themelore të cilat formojnë politikat publike të Shqipërisë, të BE-së ose të një Shteti Anëtar të BE-së.*

Parimet e pranuar të moralit i referohen *vlerave morale dhe standardeve themelore të pranuar nga shoqëria në Shqipëri dhe në Bashkimin Evropian në një moment të caktuar. Nënseksioni shpjegon se identifikimi i këtyre vlerave dhe standardeve kërkon më së paku një vlerësim empirik të asaj çfarë shoqëria përkatëse (publiku në fjalë) konsideron se është normë sjelljeje e pranueshme, në një moment të caktuar në kohë. Theksi vihet te standardet dhe vlerat morale fetare, kulturore dhe shoqërore.*

VLERËSIMI I SHENJAVE TË CILAT JANË NË KUNDËRSHTIM ME POLITIKAT PUBLIKE DHE/OSE ME PARIMET E PRANUARA TË MORALIT

Skenarët e mundshëm; Data e duhur për vlerësimin; Kriteret dhe faktorët

Ky seksion përcakton rregullat e përgjithshme për vlerësimin e shenjave që bien ndesh me politikat publike dhe/ose me parimet e pranuar të moralit.

Nënseksioni i parë mbulon skenarët e mundshëm në të cilët, në parim, shenjat do të konstatohen se bien ndesh me politikat publike ose me parimet e pranuar të moralit. Këtu bëhet dallimi midis koncepteve të moralit dhe shijes së keqe, duke sqaruar se nuk mjafton që shenja në fjalë të shihet se është me shije të keqe që ajo të bjerë në fushëveprimin e nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së.

Nënseksioni i dytë jep orientim se kur është momenti i duhur në kohë për të përcaktuar nëse një shenjë është në kundërshtim me politikat publike dhe/ose parimet e pranuar të moralit, përcaktim që në parim duhet të bazohet te politikat publike në fuqi dhe/ose te vlerat dhe normat morale themelore të pranuar në kohën kur është depozituar aplikimi për markën tregtare.

Nënseksioni i fundit shprehet se, ndërsa shqyrtimi nëse një shenjë bie ndesh me politikat publike bazohet në kriteret objektive, shqyrtimi nëse një shenjë bie ndesh me parimet e pranuar të moralit bazohet në vlera subjektive të cilat duhet të zbatohen me sa më shumë objektivitet. Këtu përshkruhen edhe kriteret dhe faktorët që duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit.

- (1) Vlerësimi i vetë shenjës. Kjo pjesë përqendrohet te vlerësimi i kuptimit ose kuptimeve të vetë shenjës, pa marrë në konsideratë mallrat dhe/ose shërbimet që janë objekt i aplikimit. Jepen parime dhe

orientime për identifikimin dhe analizën e kuptimeve të mundshme të shenjës, për vlerësimin e elementëve të tjerë fjalë dhe/ose figurë që mund të kenë ndikim te kuptimi i shenjës, për gabimet drejtshkrimore ose ndryshimet e pazakonta në sintaksë dhe për transformimet e kuptimit të shenjës.

- (2) Vlerësimi i marrëdhënies midis mallrave dhe shërbimeve dhe shenjës/ publikut përkatës. Kjo pjesë shpjegon se gjatë vlerësimit duhet të konsiderohet perceptimi i një shenje nga publiku përkatës. Për këtë qëllim, duhet të merren në analizë mallrat dhe shërbimet objekt i aplikimit, pasi ato shërbejnë për të identifikuar si publikun përkatës, ashtu edhe perceptimin që ky publik ka për shenjën. Më pas jepet informacion për parimet kryesore që lidhen me publikun përkatës dhe perceptimin e tij, duke përfshirë këtu disa elemente që mund të kenë ndikim.
- (3) Për politikat publike – përcaktimi i burimeve të besueshme dhe objektive nga të cilat mund të verifikohen këto politika publike.
- (4) Për parimet e pranura të moralit – identifikimi i vlerave dhe normave morale themelore të zbatueshme.

Janë përfshirë shembuj ilustrues, të cilët tregohen vetëm për qëllimet e vlerësimit sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të Direktivës për Markat Tregtare.

MBIVENDOSJA E POLITIKAVE PUBLIKE DHE PARIMEVE TË PRANUARA TË MORALIT

Ky seksion trajton mbivendosjen e politikave publike dhe parimeve të pranura të moralit, konkretisht rastet në të cilat kur papranueshmëria bazohet mbi të dy konceptet në të njëjtën kohë. Përveç kësaj, këtu identifikohen disa skenarë ku regjistrimi i një shenje mund të konsiderohet se bie ndesh si me politikat publike, ashtu edhe me parimet e pranura të moralit, konkretisht shenjat që lidhen me: të drejtat e njeriut; lëndët e paligjshme të cilat synojnë grupet e cënueshme; fenë; dhe me veprimtaritë/organizatat kriminale. Në këta skenarë theksi vihet te normat, parimet dhe vlerat themelore të *Shqipërisë* dhe BE-së ose Shteteve Anëtare të BE-së, në kontekstin e politikave publike, dhe te vlerat dhe normat morale themelore të shoqërisë shqiptare dhe cilësdo shoqëri në BE, në kontekstin e parimeve të pranura të moralit.

LIRIA E SHPREHJES

Në pajtim me praktikën gjyqësore të Shqipërisë dhe të BE-së, ky seksion përcakton se kur analizohet nëse një shenjë bie ndesh me nenin 4, paragrafi 1, germa “f” të Direktivës për Markat Tregtare (DMT), duhet të konsiderohet liria e shprehjes. Këtu tregohet se ndikimi këtij parimi në vlerësimin e nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së aktualisht nuk është rregulluar në legjislacionin për markat tregtare në Shqipëri ose në BE. Seksioni i referohet shtojcës për më shumë informacion për “burimet ligjore me rëndësi potenciale” për zbatimin e nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) dhe të nenit 11 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (KDTHE).

SHENJAT QË MUND TË BIEN NË FUSHËVEPRIMIN E NENIT 4, PARAGRAFI 1, GERMA “F” TË DMT-SË

Shenjat që përfshijnë/kanë lidhje me (1) lëndë të paligjshme; (2) rreziqe për sigurinë publike; (3) një lidhje fetare ose të shenjtë; (4) elemente vulgare (sharje, gjeste fyese, etj.); (5) imoralitetin, seksualitetin dhe insinuatat; (6) shenja që denigrojnë ose shpifin për një grup të veçantë; (7) veprimtari kriminale; krime kundër njerëzimit; regjime, organizata dhe lëvizje raciste, totalitare dhe ekstremiste; (8) ngjarje tragjike të njohura; (9) figura historike, simbole të BE-së ose simbole

kombëtare dhe/ose personalitete shumë të nderuara.

Për të ndihmuar vlerësimin e nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së, ky seksion i gjerë përmban një listë joshteruese të grupeve të shenjave të cilat mund të bien nën këtë motiv për refuzim. Pjesa hyrëse e këtij seksioni, ndër të tjera, shpjegon se lista e paraqitur nënkupton se shenja mund të përfshihet në më shumë se një grup. Gjithashtu, në këtë seksion sillen në kujtesë disa klauzola mosmbajtjeje së përgjegjësisë që zbatohen zakonisht në rastin e këtij motivi për refuzim si dhe nevoja për të mbajtur parasysh konsideratat e përgjithshme të përfshira në seksionin 1.3, sidomos konsideratat përfundimtare për shembujt.

Secili prej nënseksioneve mbulon një grup shenjash dhe përmban (1) një përshkrim joshterues të llojeve të shenjave të përfshira në grup, (2) një sërë parimesh që lidhen me grupin në fjalë dhe (3) shembuj për të ilustruar parimet. Çdo shembull i përfshirë në këtë seksion përbëhet nga shenja, mallrat ose shërbimet të cilave u referohet shenja, rezultatin e pritshëm duke marrë në konsideratë të gjitha hamendësimet (e papranueshme ose e pranueshme sipas nenit 4 , paragrafi 1, germa “f” të DMT-së) dhe arsyetimin ku mbështetet rezultati.



DOKUMENT PRAKTIKE

MARKAT TREGTARE NË KUNDËRSHTIM
ME POLITIKAT PUBLIKE OSE ME
PARIMET E PRANUARA TË MORALIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
PRONËSISË INDUSTRIALE (DPPI) E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TABELA E PËRMBAJTJES

1	HYRJE.....	1
1.1	Objektivi i këtij Dokumenti Praktike	1
1.2	Konteksti	1
1.3	Fushëveprimi i praktikës	1
2	PRAKTIKA	3
2.1	Kuptimet.....	3
2.1.1	Kuptimi i politikave publike ()	3
2.1.2	Kuptimi i parimeve të pranuar të moralit	5
2.2	Vlerësimi i shenjave në kundërshtim me politikat publike dhe/ose parimet e pranuar të moralit	5
2.2.1	Skenarët e mundshëm.....	5
2.2.1.1	<i>Shija e keqe</i>	6
2.2.2	Data e duhur për vlerësimin.....	6
2.2.3	Kriteret dhe faktorët	6
2.2.3.1	<i>Vlerësimi i vetë shenjës</i>	7
2.2.3.2	<i>Vlerësimi i marrëdhënies ndërmjet mallrave e shërbimeve dhe shenjës/publikun përkatës</i>	10
2.2.3.3	<i>Përcaktimi i burimeve të besueshme dhe objektive nga të cilat mund të vërtetohen politikat publike</i>	14
2.2.3.4	<i>Identifikimi i vlerave morale dhe standardeve themelore</i>	15
2.3	Mbivendosja e politikave publike dhe e parimeve të pranuar të moralit.....	15
2.4	Liria e shprehjes	16
2.5	Shenjat që mund të bien në fushëveprimin e nenit 4, paragrafi 1, germa “F” të DMT-së	17
2.5.1	Shenjat që përmbajnë/lidhen me lëndë të paligjshme	17
2.5.2	Shenjat që u referohen/janë të lidhura me rreziqet për shëndetin publik	21
2.5.3	Shenjat që kanë lidhje me fenë ose shenjtërinë.....	23
2.5.4	Shenjat që përmbajnë/lidhen me elementë vulgarë (sharje, gjeste fyese etj.).....	26
2.5.5	Shenjat që përmbajnë/lidhen me paturpësinë, seksualitetin dhe insinuatat	28
2.5.6	Shenja që denigrojnë ose shpifin për një grup të veçantë	30
2.5.7	Shenja që i referohen/lidhen me veprimtari kriminale; krime kundër njerëzimit; regjime, organizata dhe lëvizje raciste, totalitare dhe ekstremiste.....	33
2.5.8	Shenja që u referohen ngjarjeve tragjike të njohura.....	35
2.5.9	Shenjat që përmbajnë/lidhen me figura historike, simbole të BE-së ose simbole kombëtare dhe/ose personalitete shumë të nderuara.....	37

1 HYRJE

1.1 Objektivi i këtij Dokumenti Praktike

Ky Dokument Praktike përcakton parimet e përgjithshme për vlerësimin e shenjave që bien ndesh me politikat publike ose me parimet e pranuar të moralit, në veçanti, për kuptimin e këtyre koncepteve, marrëdhënien midis tyre, kriteret për vlerësimin e tyre, të shoqëruar me shembuj të shenjave që mund të konsiderohen në kundërshtim me politikat publike dhe/ose me parimet e pranuar të moralit. Ky dokument shërben si referencë për Zyrën e Pronësisë Intellektuale të Republikës së Shqipërisë, shoqatat e përdoruesve si dhe për aplikuesit e përfaqësuesit e tyre.

Dokumenti është botuar për të qenë gjerësisht i disponueshëm dhe do të aksesohet me lehtësi, duke ofruar një shpjegim të qartë dhe gjithëpërfshirës të parimeve në të cilat bazohet Praktika. Këto parime janë menduar që të zbatohen në mënyrë të përgjithshme dhe synojnë të mbulojnë shumicën e rasteve. Duhet të vërehet se **vlerësimi nëse një shenjë është në kundërshtim me politikat publike dhe/ose parimet e pranuar të moralit do të kryhet gjithmonë rast pas rasti, pasi ato janë ngushtësisht të lidhura me normat dhe vlerat që mbizotërojnë në shoqëri në një moment të caktuar.**

Për më tepër, shembujt në këtë dokument synojnë të ilustrojnë parimet e Praktikës. Këta shembuj duhet të shihen në lidhje me parimet dhe të bazohen në supozimet mbi të cilat ata mbështeten. Ata gjithashtu duhet të kuptohen si demonstrues të disa parimeve të Praktikës dhe jo si përfundime detyruese se çfarë është në kundërshtim me politikat publike ose me parimet e pranuar të moralit në nivel kombëtar.

1.2 Konteksti

Markat tregtare në kundërshtim me politikat publike ose me parimet e pranuar të moralit

Neni 4, paragrafi 1, germa “f” i DMT-së parashikon një arsye për refuzim ose pavlefshmëri të markave tregtare që janë në kundërshtim me politikat publike ose me parimet e pranuar të moralit. Megjithatë, formulimi i nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së është shumë i gjerë dhe është subjekt interpretimi, pasi nuk përmban një përkufizim se çfarë duhet të kuptojmë me “politika publike” ose me “parime të pranuar të moralit” dhe as nuk sqaron marrëdhënien midis këtyre dy koncepteve.

Edhe pse praktika gjyqësore e BE-së ka dhënë ndonjë orientim për këtë çështje⁽¹⁾, ende [ka/ka pasur] paqartësi për aspektet vendimtare të vlerësimit të dispozitës, për shembull marrëdhëniet dhe dallimet midis dy koncepteve, nëse mund të mbivendosen dhe në cilat raste mund të mbivendosen si dhe kriteret që duhen marrë në konsideratë gjatë vlerësimit.

1.3 Fushëveprimi i praktikës

Kjo Praktikë shpreh kuptimet e nocioneve të politikave publike dhe të parimeve të pranuar të moralit; një grup parimesh për vlerësimin e nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së dhe për kriteret e zbatueshme për këtë vlerësim; si dhe shembuj ilustrues për të treguar kriteret e zbatueshme.

Brenda fushëveprimit të Praktikës hyjnë çështjet e mëposhtme:

- kuptimet e koncepteve të politikave publike dhe të parimeve të pranuar të moralit dhe të koncepteve të tjera që lidhen me vlerësimin e tyre (p.sh. sqarimi i marrëdhënies dhe dallimet midis dy koncepteve, nëse konceptet duhet të shqyrtohen më vete ose në bashkëlidhje dhe në cilat raste duhet bërë ky shqyrtim, kufiri ndarës midis konceptit të parimeve të pranuar të moralit dhe konceptit të shijes së keqe);

⁽¹⁾ 27/02/2020, C-240/18 P, Fack Ju Göhte, EU:C:2020:118 dhe Opinioni i Avokatit të Përgjithshëm Bobek, dhënë më 2 korrik 2019 në çështjen 27/02/2020, C-240/18 P, Fack Ju Göhte, EU:C:2020:118.

- vlerësimi nëse shenja është në kundërshtim me politikat publike dhe/ose parimet e pranuar të moralit si dhe interpretimi dhe zbatimi i tyre (p.sh. vlerësimi i vetë shenjës, mallrat/shërbimet e mbuluara nga aplikimi për regjistrim, identifikimi dhe sqarimi i publikut përkatës, kontekstet dhe rrethanat që ndikojnë te perceptimi i shenjës); dhe
- shembuj ilustrues të kriterëve dhe grupeve të shenjave të identifikuar.

Çështjet e mëposhtme janë **jashtë fushëveprimet** të Praktikës:

- çfarë shihet ose duhet të shihet si e ligjshme brenda vendit;
- vlerësimi i të drejtave të tjera të pronësisë intelektuale dhe ndikimi i tyre në regjistrueshmërinë e markës tregtare sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së;
- mënyra e kryerjes së vlerësimit të lirisë së shprehjes në lidhje me nenin 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së (megjithatë, liria e shprehjes duhet të merret parasysh kur analizohet nëse shenja është në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së);
- aspektet procedurale që i përkasin Zyrës së Pronësisë Intelektuale të Republikës së Shqipërisë, të tilla si shqyrtimi kryesisht dhe procedurat e anulimit etj.;
- çështjet e lidhura me gjuhën në shembujt që mund të përdoren në dokumentin e Praktikës (p.sh. të gjithë shembujt janë në anglisht dhe do të supozohet se ata do të kuptohen ashtu siç do t'i kuptonte një person që anglishten e ka gjuhë amtare); dhe
- trashëgimia kulturore në kontekstin e nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së⁽²⁾.

Konsiderata të përgjithshme	
Vlerësimi rast pas rasti	Pavarësisht se parimet e përvijuara më poshtë mund të ofrojnë orientime në vlerësimin e vendimeve, të gjitha aplikimet duhet të vlerësohen rast pas rasti duke marrë në konsideratë nivelin normal të ndjeshmërisë dhe tolerancës së publikut përkatës në juridiksion, rrethanat që janë specifike për Shqipërinë ose një Shtet Anëtar të BE-së si dhe rastin konkret.
Mbivendosja e politikave publike dhe parimeve të pranuar të moralit	Në rastet ku një shenjë është në kundërshtim edhe me politikat publike edhe me parimet e pranuar të moralit, do të zbatohen kriteret e zbatueshme për secilën prej tyre.
Liria e shprehjes	Në pajtim me praktikën gjyqësore të BE-së, kur analizohet nëse një shenjë është në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së duhet të merret parasysh liria e shprehjes. Megjithatë, fakti që një shenje i refuzohet regjistrimi, nuk e pengon përdorimin e saj në tregti. Duke qenë se ndikimi i lirisë së shprehjes në vlerësimin e nenit 4 paragrafi 1, germa “f” të DMT-së nuk është rregulluar në ligjin për markat tregtare në Shqipëri ose në BE, ky dokument Praktike nuk analizon si duhet kryer vlerësimi. Shtojca për materialet e burimeve ligjore që trajtojnë lirinë e shprehjes është bashkëngjitur këtu vetëm për qëllime informacioni.
Subjektiviteti	Pavarësisht orientimeve të dhëna nga parimet e rëna dakord më poshtë, vlerësimi i nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së mund të ketë një element subjektiv. Si i tillë, ky nen duhet të zbatohet nga shqyrtuesit e aplikimeve të cilët duhet të parashatrojnë me objektivitet arsyet, aty ku është e mundur, duke përdorur burime të pavarura dhe të besueshme për të mbështetur vendimet e tyre.
Shembujt	Shembujt e dhënë këtu janë treguar vetëm për qëllimet e vlerësimit të nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së. Fakti që disa prej tyre mund të jenë të pranueshme sipas kësaj dispozite, nuk do të thotë se ato nuk mund të refuzohen duke u bazuar në arsye të tjera për refuzim (p.sh. mungesa e

⁽²⁾ Për shkak të mungesës së orientimeve nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, është konsideruar e nevojshme që kjo temë të lihet jashtë fushëveprimet të projektit.

	dallueshmërisë dhe karakteri përshkrues). Edhe pse disa terma mund të njihen në disa gjuhë, të gjithë shembujt janë në anglisht dhe do të mendohet se ata do të kuptohen ashtu siç do t'i kuptonte një person që anglishten e ka gjuhë amtare.
--	--

2 PRAKTIKA

Sipas nenit 4 paragrafi 1, germa “f” të DMT-së, markat tregtare në kundërshtim me politikat publike ose me parimet e pranura të moralit nuk regjistrohen ose, nëse regjistrohen, janë të prirura të deklarohen të pavlefshme. Në rastet ku, në parim, arsyet absolute për refuzim kanë bazë kryesisht tregtare, politikat publike dhe morali mbrojnë ose përkrahin më shumë parimet bazë dhe vlerat themelore që përcaktohen këtu më poshtë. Gjithashtu, qëllimi i kësaj arsyeje për refuzim nuk është të identifikojë dhe filtrojë shenjat që duhet të ndalohen me çdo kusht të përdoren në tregti; në të vërtetë, arsyetimi i dispozitës është që përfitimet nga regjistrimi i markës tregtare nuk duhet të jepen në favor të shenjave që janë në kundërshtim me politikat publike dhe/ose parimet e pranura të moralit të njohura në Shqipëri. Organet e qeverisjes dhe administratës publike nuk mund të japin status zyrtar, kështu ato duhet të parandalojnë legjitimitimin në shoqëri të shenjave që shkelin disa vlera bazë të shoqërive demokratike. Megjithatë, fakti që shenja është refuzuar sipas dispozitës së nenit 4 paragrafi 1, germa “f” të DMT-së nuk e pengon përdorimin e saj.

Është me rëndësi të vërehet se, nëse aplikimi refuzohet sipas nenit 4 paragrafi 1, germa “f” të DMT-së, refuzimi nuk mund të anashkalohet me anë të dallueshmërisë së markës tregtare të fituar nga përdorimi (neni 4, paragrafi 4, i DMT-së). Megjithatë, kur vlerësohet perceptimi i shenjës nga publiku përkatës, duhet të merren parasysh përdorimet e mëparshme të shenjës, duke përfshirë edhe mënyrën si mund të kenë ndikuar në perceptim këto përdorime të saj ⁽³⁾.

Për më tepër, çështja nëse marka tregtare mund të regjistrohet sipas nenit 4 paragrafi 1, germa “f” të DMT-së është e ndarë nga çështja nëse në Shqipëri është i ligjshëm ofrimi ose përdorimi i mallrave dhe/ose shërbimeve për të cilat është regjistruar shenja. Prandaj, është vetë marka, konkretisht shenja në lidhje me mallrat ose shërbimet ashtu si shfaqen në aplikimin për markën tregtare, e cila duhet të vlerësohet për të përcaktuar nëse është në kundërshtim me politikat publike ose me parimet e pranura të moralit ⁽⁴⁾.

2.1 Kuptimet

2.1.1 Kuptimi i politikave publike ⁽⁵⁾

Politikat publike mund të kuptohen si një grup normash, parimesh dhe vlerash themelore të shoqërisë në Shqipëri në një pikë të caktuar në kohë. Në veçanti, ato përfshijnë vlerat universale të Shqipërisë si dinjiteti i njeriut, liria, barazia dhe solidariteti si dhe parimet e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, ashtu siç janë shpallur në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (KDTBE). Përmbajtja e tyre duhet të jetë e vërtetueshme nga burime të besueshme dhe objektive.

Më poshtë gjendet një listë joshteruese e tematikave që janë jashtë fushëveprimit të **normave themelore**.

- Politika e jashtme dhe e sigurisë ⁽⁶⁾: norma të cilat, ndër të tjera, ruajnë paqen, luftojnë terrorizmin, mbrojnë

⁽³⁾ Për këtë shih 27/02/2020, C-240/18 P, Fack Ju Göhte, EU:C:2020:118, § 51

⁽⁴⁾ 13.09.2005, T-140/02, Intertops, EU:T:2005:312, § 27.

⁽⁵⁾ Termi “politika publike” përkon me formulimin në variantin anglisht të nenit 4 paragrafi 1, germa “f” të DMT-së. Megjithatë, legjislacioni i disa Shteteve Anëtare përdor fjalë të tjera për t’iu referuar të njëjtit koncept gjatë transpozimit të kësaj dispozite (p.sh. rend publik, *ordre public*, etj.). Në përkthimin e këtij dokumenti, termi “politika publike” duhet të kuptohet dhe përkthehet sipas formulimit të legjislacionit të Shteteve Anëtare kur i referohen të barasvlershmit të nenit 4 paragrafi 1, germa “f” të DMT-së.

⁽⁶⁾ https://europa.eu/european-union/topics/foreign-security-policy_en

shtetin e së drejtës si dhe zhvillojnë e konsolidojnë demokracinë.

- Politikat shëndetësore ⁽⁷⁾: norma që synojnë, ndër të tjera, të mbrojnë dhe përmirësojnë shëndetin e qytetarëve shqiptarë dhe të pajisin Shqipërinë për të parandaluar dhe përballuar më mirë kërcënimet serioze për shëndetin.
- Ndihmat humanitare dhe mbrojtja civile ⁽⁸⁾: norma që synojnë dhënien e ndihmës kur ndodhin katastrofa madhore ose emergjenca humanitare.
- Përkrahja dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, lirive themelore dhe drejtësisë ⁽⁹⁾: norma të cilat kanë për qëllim që qytetarët shqiptarë të gëzojnë të njëjtat të drejta themelore të bazuara në vlerat e barazisë, mosdiskriminimit, gjithëpërfshirjes, dinjitetit të njeriut, lirisë dhe demokracisë, të cilat mbrohen nga shteti i së drejtës – ndër të tjera, përkrahja dhe mbrojtja e të drejtave të grave, fëmijëve, pakicave dhe personave të shpërngulur; mbrojtja e të drejtave të njeriut nëpërmjet partneritetit aktiv, mbrojtja e të drejtave shoqërore e kulturore etj.

Për më tepër, ky kuptim ofron një listë të pakufizuar të **parimeve dhe vlerave themelore** ⁽¹⁰⁾ në një shoqëri ku mbizotërojnë gjithëpërfshirja, toleranca, drejtësia, solidariteti në bazë të, ndër të tjera, gjinisë, racës, ngjyrës, origjinës etnike ose shoqërore, karakteristikave gjenetike, gjuhës, fesë ose besimit, opinionit, lindjes, aftësive të kufizuara, moshës ose orientimit seksual. Këto vlera dhe parime themelore janë ⁽¹¹⁾:

- dinjiteti i njeriut,
- liria,
- barazia,
- solidariteti,
- demokracia,
- shteti i së drejtës,
- respektimi i të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave.

Kërkesat e politikave publike ndryshojnë me kohën, në funksion të nevojave specifike të shoqërisë. Shqipëria mbetet thelbësisht e lirë të përcaktojë përmbajtjen e këtyre kërkesave në pajtim me nevojat kombëtare dhe me detyrimet e saj ndërkombëtare ⁽¹²⁾ ⁽¹³⁾.

Në fund, normat, parimet dhe vlerat themelore që formojnë politikat publike të Shqipërisë **duhet të jenë të vërtetueshme nga burime të besueshme dhe objektive**, si ato të përfshira në listën joshteruese të mëposhtme ⁽¹⁴⁾:

- parimet e përgjithshme të ligjit,

⁽⁷⁾ https://europa.eu/european-union/topics/health_en

⁽⁸⁾ https://european-union.europa.eu/priorities-and-actions/actions-topic/humanitarian-aid-and-civil-protection_en

⁽⁹⁾ https://european-union.europa.eu/priorities-and-actions/actions-topic/human-rights-and-democracy_en dhe https://european-union.europa.eu/priorities-and-actions/actions-topic/justice-and-fundamental-rights_en

⁽¹⁰⁾ Versionet e ndryshme të Traktateve të BE-së përdorin nocionet e “vlerave” dhe “parimeve” në mënyrë të këmbyeshme për t’iu referuar parimeve dhe vlerave të përmendura në këtë seksion (p.sh. Traktati i Amsterdimit dhe Traktati i Mastroitit përmendin se “Bashkimi themelohet mbi parimet e lirisë, demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut e lirive themelore si dhe mbi shtetin e së drejtës, parime të cilat janë të përbashkëta për të gjitha Shtetet Anëtare”). Prandaj, për hir të qartësisë, këto nocione janë zhvilluar së bashku.

⁽¹¹⁾ Këto vlera dhe parime janë parashikuar në [KDThBE](#) dhe në [Traktatin e Lisbonës](#) i cili ndryshon Traktatin e Bashkimit Evropian dhe Traktatin që krijon Komunitetin Evropian, nënshkruar në Lisbonë më 13 dhjetor 2007.

⁽¹²⁾ 12/05/2021, T-178/20, Bavaria Weed (fig.), EU:T:2021:259, § 40.

⁽¹³⁾ Sipas nenit 4, paragrafi 3, të DMT-së: “Çdo Shtet Anëtar mund të parashikojë që një markë tregtare të mos regjistrohet ose, nëse regjistrohet, të mund të deklarohet e pavlefshme nëse dhe në masën që: (a) përdorimi i asaj marke tregtare mund të ndalohej sipas parashikimeve ligjore të ndryshme nga ligji për markat tregtare të Shtetit Anëtar në fjalë ose të Bashkimit”.

⁽¹⁴⁾ Seksioni 2.2.3 zhvillon më tej burimet që duhet të konsiderohen patjetër dhe burime të tjera të cilat mund të konsiderohen, nëse është e përshtatshme.

- traktatet dhe konventat ndërkombëtare,
- traktatet e BE-së,
- legjislacioni i BE-së,
- praktika gjyqësore e BE-së,
- legjislacioni shqiptar në fuqi,
- praktika gjyqësore shqiptare.

2.1.2 Kuptimi i parimeve të pranuar të moralit

Me **parime të pranuar të moralit kuptojmë** vlerat morale dhe standardet themelore të pranuar nga shoqëria shqiptare në një moment të caktuar.

Identifikimi i **vlerave morale dhe standardeve themelore të zbatueshme** kërkon më së paku një vlerësim empirik të asaj çfarë shoqëria përkatëse (publiku në fjalë) konsideron se është normë sjelljeje e pranueshme në një moment të caktuar në kohë ⁽¹⁵⁾, sidomos për faktin se ato ndryshojnë me kohën.

Duke qenë se vlerat dhe standardet morale ndikohen, ndër të tjera, nga besimet, sfondi kulturor dhe rrjeti shoqëror i një shoqërie, theksi vihet tek elementët e mëposhtëm:

- **Vlerat dhe standardet fetare:** ato që pasqyrojnë besimet dhe praktikët e një grupi fetar, si respekti që i jepet një doktrine të veçantë fetare, adhuresit e asaj feje, ceremonitë që i përkasin asaj feje, tekstet e shenjta, simbolet e shenjta etj.
- **Vlerat dhe standardet kulturore:** ato që pasqyrojnë traditën e një kulture dhe të njerëzve që e formojnë atë, si respektimi dhe mbrojtja e zakoneve dhe traditave, ritualet/ceremonitë, simbolet kulturore ose gjuha e një grupi të veçantë etj.
- **Vlerat dhe standardet shoqërore:** ato që pasqyrojnë identitetin e një komuniteti. Në përgjithësi, këto vlera lindin, ndër të tjera, nga rrjetet politike, arsimore dhe komunitare të një grupi të caktuar dhe do të vareshin nga shtrirja e veçantë gjeografike dhe shoqërore.

2.2 Vlerësimi i shenjave në kundërshtim me politikat publike dhe/ose parimet e pranuar të moralit

Nga formulimi i nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së, mund të dilet në përfundimin se kjo arsye absolute përfshin dy koncepte të ndryshme: marka tregtare në kundërshtim me politikat publike dhe markat tregtare në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit. Edhe pse konceptet e politikave publike dhe parimeve të pranuar të moralit mund të mbivendosen në disa raste, konstatimi se shenja është në kundërshtim vetëm me politikat publike ose në kundërshtim vetëm me parimet e pranuar të moralit mjafton për ta refuzuar shenjën në pajtim me nenin 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së. Megjithatë, në rastet ku shenja konsiderohet se është në kundërshtim edhe me politikat publike edhe me parimet e pranuar të moralit, duhet të kryhet vlerësimi për të dy rastet. Në këtë aspekt, vendimet e Zyrës së Pronësisë Intelektuale të cilat refuzojnë shenjën në bazë të nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së duhet të shprehin qartë arsyet ku janë mbështetur këto vendime.

2.2.1 Skenarët e mundshëm

Në parim, shenja do të jetë në kundërshtim me politikat publike nëse, ndër të tjera, mohon dhe/ose nxit, lavdëron, banalizon ose justifikon shkeljen e një norme, parimi dhe/ose vlere themelore, e vërtetuar kjo nga burimet e besueshme dhe objektive të përmendura në seksionin 2.1.1. Prandaj, shenja

⁽¹⁵⁾ Opinioni i Avokatit të Përgjithshëm Bobek, 27/02/2020, C-240/18 P, Fack Ju Göhte, EU:C:2020:118, § 80.

duhet të prekë një interes që Shqipëria e konsideron themelor në pajtim me sistemin e saj të vlerave ⁽¹⁶⁾.

Në parim, një shenjë do të jetë në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit nëse, ndër të tjera, perceptohet se njëra prej vlerave morale dhe standardeve themelore të përmendura në seksionin 2.1.2 është fyer, denigruar, diskriminuar, zvetënuar ose banalizuar në atë mënyrë që shkakton shkelje.

Për qëllime të zbatimit të nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së, shenja duhet të përçojë të paktën një kuptim i cili të jetë **qartazi në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit ose me politikat publike.**

2.2.1.1 Shija e keqe

Shija e keqe dhe morali janë koncepte të ndryshme. Siç shprehet Gjykata e Drejtësisë, për të qenë brenda fushëveprimit të nenit 7, paragrafi 1, germa “f” të Rregullores së BE-së për Markat Tregtare (ekuivalenti i nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së, nuk mjafton që shenja në fjalë të shihet si me **shije të keqe**. Ajo duhet të perceptohet nga publiku përkatës se bie ndesh me vlerat morale dhe standardet themelore të shoqërisë, ashtu siç ekzistojnë në atë moment ⁽¹⁷⁾.

Shenja që shihet si me shije të keqe është shenjë vulgare, e parafinuar ose e vrazhdë, por nuk është fyese për një person me ndjeshmëri dhe tolerancë normale. Këto shenja nuk do të përbëjnë shkelje të parimeve të pranuar të moralit.

2.2.2 Data e duhur për vlerësimin

Në parim, vlerësimi nëse shenja është në kundërshtim me politikat publike dhe/ose parimet e pranuar të moralit duhet të bazohet te politikat publike në fuqi dhe/ose te vlerat morale dhe standardet themelore të pranuar **në kohën kur është depozituar aplikimi për markën tregtare** ⁽¹⁸⁾. Megjithatë, mund të ketë rrethana tejet të veçanta në të cilat politikat publike në fuqi dhe/ose vlerat morale dhe standardet themelore të pranuar mund të ndikohen nga një ngjarje e cila ka ndodhur pas datës së depozitimit të aplikimit. Në këto raste, në parim, edhe këto ngjarje mund të merren në konsideratë ⁽¹⁹⁾.

2.2.3 Kriteret dhe faktorët

Ndërkohë që shqyrtimi nëse shenja është në kundërshtim me **politikat publike** bazohet në **kritere objektive** ⁽²⁰⁾, shqyrtimi nëse shenja është në kundërshtim me **parimet e pranuar të moralit** bazohet në **vlera subjektive**, të cilat duhet të **zbatohen sa më me objektivitet** ⁽²¹⁾. Megjithatë, të dy konceptet duhet të shqyrtohen duke marrë në konsideratë kriteret dhe faktorët e mëposhtëm.

- Vlerësimi i vetë shenjës

- Identifikimi dhe analiza e kuptimeve të ndryshme të shenjës
- Vlerësimi i elementëve fjalë dhe/ose figurë shtesë të cilët mund të ndikojnë në kuptimin e shenjës
- Gabimet drejtshkrimore ose ndryshimet e pazakonta në sintaksë

⁽¹⁶⁾ 12/12/2019, T-683/18, CANNABIS STORE AMSTERDAM (fig.), EU:T:2019:855, § 73. Vendimi i referohet nenit 7, paragrafi 1, germa “f” të Rregullores së BE-së për Markat Tregtare, i cili përputhet me nenin 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së.

⁽¹⁷⁾ 27/02/2020, C-240/18 P, Fack Ju Göhte, EU:C:2020:118, § 41.

⁽¹⁸⁾ 03/06/2009, T-189/07, Flugbörse, EU:T:2009:172; lënë në fuqi më 23.04.2010, C-332/09 P, Flugbörse, EU:C:2010:225.

⁽¹⁹⁾ Për shembull çështja “BIN LADIN”, Vendimi R 176/2004-2 i Bordit të Apelimit të EUIPO-së: pavarësisht se aplikimi për markën tregtare “BIN LADIN” është bërë 4 muaj para sulmeve terroriste të 11 shtatorit, ngjarjet dhe rrethanat që lindën gjatë procesit të shqyrtimit morën në konsideratë.

⁽²⁰⁾ Opinioni i Avokatit të Përgjithshëm Bobek, dhënë më 2 korrik 2019(1) në çështjen 27/02/2020, C-240/18 P, Fack Ju Göhte, EU:C:2020:118, § 78.

⁽²¹⁾ Opinioni i Avokatit të Përgjithshëm Bobek, dhënë më 2 korrik 2019(1) në çështjen 27/02/2020, C-240/18 P, Fack Ju Göhte, EU:C:2020:118, § 80.

- Transformimi i kuptimit të shenjës
- **Vlerësimi i marrëdhënies ndërmjet mallrave e shërbimeve dhe shenjës/publikun përkatës**
 - Analiza e mallrave dhe shërbimeve
 - Publiku përkatës
 - Nuk kufizohet te publiku i synuar
 - Standardi i një personi të arsyeshëm me ndjeshmëri dhe prag tolerance mesatar
 - Interesi publik rreth regjistrimit të fjalëve fyese
 - Perceptimi i publikut përkatës
 - Ndikimi i mallrave dhe/ose shërbimeve në perceptimin e shenjës
 - Fushëveprimi gjuhësor dhe gjeografik
 - Konteksti dhe rrethanat e veçanta të cilat mund të kenë ndikim në perceptimin e shenjës
- **Për politikat publike: Përcaktimi i burimeve të besueshme dhe objektive nga të cilat mund të vërtetohen politikat publike**
- **Për parimet e pranuar të moralit: Identifikimi i vlerave morale dhe standardeve themelore**

Nënseksionet e mëposhtme zhvillojnë kriteret dhe faktorët e përmendur më lart dhe përmbajnë shembuj ilustrues, të cilët tregohen vetëm për qëllime të vlerësimit të nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së.

2.2.3.1 Vlerësimi i vetë shenjës

Ky nënseksion përqendrohet te vlerësimi i kuptimit/kuptimeve të vetë shenjës, domethënë i elementëve fjalë dhe/ose figurë, pa marrë në konsideratë mallrat dhe shërbimet që janë subjekt i aplikimit ⁽²²⁾.

a) Identifikimi dhe analiza e kuptimeve të ndryshme të shenjës

Është e nevojshme të vlerësohen elementët fjalë dhe/ose figurë dhe të identifikohen kuptimet e mundshme të shenjës dhe/ose mesazhi i përçarë prej saj në gjuhët që kuptohen në Shqipëri. Më pas, duhet të bëhet një analizë nëse ndonjëri prej këtyre kuptimeve dhe nuancave të mundshme mund të jetë në kundërshtim me politikat publike ose me parimet e pranuar të moralit. Për këtë qëllim, mund të konsideroheshin të gjitha përdorimet që mund të ketë një fjalë e caktuar (formal, bashkëbisedor, zhargon etj.).

Vlerësimi i të gjitha kuptimeve të mundshme të shenjës dhe/ose mesazhit të përçarë prej tij mund të vërtetohen, ndër të tjera, nga zëra të besueshëm të një fjalori, nga enciklopeditë ose nga shembuj të përdorimit të termit (që përmban shenja) të gjetur në faqet e internetit. Në parim, këto burime referencash do të jepnin një të dhënë paraprake nëse shenja mund të jetë në kundërshtim me politikat publike ose me parimet e pranuar të moralit.

⁽²²⁾ Synimi i kësaj pike është të përcaktohen kuptimet e shenjës dhe nëse ndonjëri prej tyre lidhet në mënyrë të veçantë me vlerësimin e nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së. Mallrat dhe/ose shërbimet që kanë lidhje me shenjën analizohen në nënseksionin vijues (2.2.3.2).

Nëse njëri prej këtyre kuptimeve të mundshme është në kundërshtim me politikat publike ose me parimet e pranura të moralit, ky kuptim duhet të konsiderohet si pjesë e vlerësimit të nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së.

Kuptimi që mund të merret në konsideratë për vlerësimin e nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së	
Shenja	Arsyetimi
	Sipas fjalorit “Collins”, elementi fjalë “SS” mund t’i referohet, ndër të tjera, shkurtimit të fjalës anije me avull ose Shenjtorë. Megjithatë, me “SS” mund të kuptohet edhe shkurtimi i emrit të një organizate të partisë naziste të Luftës së Dytë Botërore, e cila u shpall organizatë kriminale për shkak të përfshirjes së saj të drejtpërdrejtë në kryerjen e mizorive të luftës. Një markë tregtare me një kuptim të tillë mund të perceptohet se i thur lavde dhe/ose banalizon nazizmin dhe veprimet kriminale të organizatës, të cilat bien ndesh me vlerat universale të pandashme mbi të cilat është themeluar BE-ja, konkretisht dinjiteti i njeriut, liria dhe integriteti fizik. Prandaj, ky kuptim duhet të merret në konsideratë për vlerësimin e nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së.
	Sipas fjalorit “Oxford”, elementi fjalë “PUSSY” mund t’i referohet fjalës me të cilën një fëmijë thërret macen ose një fjalë në zhargon me të cilën kuptohen organet seksuale femërore. Kështu, kjo shenjë mund të perceptohet si fyese. Prandaj, ky kuptim duhet të merret në konsideratë për vlerësimin e nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së.

b) Vlerësimi i elementëve fjalë dhe/ose figurë shtesë të cilët mund të ndikojnë në kuptimin e shenjës

Në vlerësimin e shenjës duhet të konsiderohet nëse, përveç elementit të identifikuar që mund të jetë në kundërshtim me politikat publike ose parimet e pranura të moralit, shenja përmban elementë të tjerë që mund të ndikojnë në kuptimin e shenjës. Mund të ketë raste në të cilat **elementët fjalë ose figurë shtesë të shenjës mund të eliminojnë dhe/ose neutralizojnë kuptimin e papranueshëm të saj.**

Kombinimi i elementëve <u>eliminon dhe/ose neutralizon</u> kuptimin e papranueshëm të shenjës	
Shenja	Arsyetimi
	Sipas fjalorit “Oxford”, elementi fjalë “DICK” është element vulgar në zhargon për t’iu referuar penisit të një mashkulli. Megjithatë, “Dick” është edhe trajta zvogëluese e emrit Richard. Kombinimi i elementëve fjalë “LITTLE DICK” dhe i elementit figurë i një fëmije naiv eliminon kuptimin e mundshëm vulgar dhe fyes, pasi këtu përçohet mesazhi se shenja i referohet fëmijës së vogël i njohur me emrin “Dick”.
	Sipas fjalorit “Oxford”, elementi fjalë “PUSSY” mund t’i referohet fjalës me të cilën një fëmijë thërret macen ose një fjalë në zhargon me të cilën kuptohen organet seksuale femërore. Kombinimi i elementit fjalë me elementin figurë të putrës së maces eliminon kuptimin vulgar dhe fyes të shenjës, pasi këtu përçohet mesazhi se shenja i referohet maces.

Nga ana tjetër, mund të ketë raste ku **elementët fjalë ose figurë shtesë të shenjës përforcojnë kuptimin e papranueshëm** të saj, në kuptimin që shenja dhe/ose mesazhi i përçarë prej saj mund të jenë në kundërshtim me politikat publike ose me parimet e pranuar të moralit.

Kombinimi i elementëve përforcon kuptimin e papranueshëm të shenjës	
Shenja	Arsyetimi
	Sipas fjalorit "Oxford", elementi fjalë "DICK" është term vulgar në zhargon i përdorur për t'iu referuar penisit të një mashkulli. "Dick" është edhe trajta zvogëluuese e emrit Richard. Kombinimi i elementit fjalë "LITTLE DICK" me pasqyrimin e një bananeje që zëvendëson germën "l" thekson kuptimin vulgar dhe fyes. Prandaj, ky kuptim duhet të merret në konsideratë për vlerësimin e nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së.
	Sipas fjalorit "Oxford", elementi fjalë "PUSSY" mund t'i referohet fjalës me të cilën një fëmijë thërret macen ose një fjalë në zhargon me të cilën kuptohen organet seksuale femërore. Kombinimi i elementit fjalë me pasqyrimin e buzëve të një gruaje duket se i referohet kuptimit seksual të termit "pussy", duke përforcuar kështu kuptimin vulgar dhe fyes. Prandaj, ky kuptim duhet të merret në konsideratë për vlerësimin e nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së.

c) Gabimet drejtshkrimore ose ndryshimet e pazakonta në sintaksë

Edhe një gabim drejtshkrimor ose ndryshim i pazakontë në sintaksë mund të zbutë bashkëshoqërimin e menjëhershëm me konotacionin negativ të shenjës. Megjithatë, nuk është ky rasti kur, si rezultat i gabimit drejtshkrimor ose ndryshimit të pazakontë, shqiptimi i shenjës është identik me termin ose shprehjen e papranueshme.

Gabim drejtshkrimor ose ndryshim i pazakontë në sintaksë	
Shenja	Arsyetimi
THERAPIST JOHN	Elementët fjalë të shenjës i referohen terapeutit të quajtur John. Prandaj, shenja nuk përçon asnjë kuptim fyes për t'u konsideruar sipas nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së.
THE.RAPIST JOHN	Në kundërshtim me shenjën e mësipërme, vendosja e pikës ndërmjet germave "E" dhe "R" krijon një ndryshim në kuptimin e shenjës duke shtuar një referim ndaj fjalës përdhunues, domethënë, për një kriminel të quajtur John. Prandaj, ky kuptim duhet të merret në konsideratë për vlerësimin e nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së.

d) Transformimi i kuptimit të shenjës

Kur kryhet shqyrtimi sipas politikave publike, duhet marrë në konsideratë edhe **nëse elementët fjalë dhe/ose figurë që përmban shenja dhe/ose mesazhi i përçarë prej saj janë transformuar** në atë pikë sa nuk do të ishin më në kundërshtim me politikat publike në datën e depozitimit të aplikimit për markën tregtare. Sa i takon parimeve të pranuar të moralit, shqyrtimi duhet të përcaktojë **nëse elementët e lartpërmendur të shenjës me kohën e kanë humbur kuptimin e tyre fyes**. Në parim kjo gjë duhet të përcaktohet duke iu referuar kohës së depozitimit të aplikimit për markën tregtare.

E pranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së	
Shenja	Arsyetimi
	Flamuri i piratëve (flamur i zi me një kafkë dhe kocka të kryqëzuara në të) tradicionalisht ka qenë lidhur me piratët. Pirateria është akt vjedhjeje dhe/ose dhune kriminale nga një anije kundrejt një anijeje tjetër ose një zone bregdetare, i cili është problem dhe krim që ndodh rëndom në mjaft vende. Megjithatë, sot flamuri i piratëve nuk përdoret ose lidhet me llojet e lartpërmendura të krimeve dhe shenja nuk perceptohet se lavdëron dhe/ose banalizon ose justifikon dëmin serioz

	<i>që i shkaktojnë piratët vlerave themelore të BE-së si dinjiteti i njeriut, siguria dhe siguri. Prandaj, kuptimi i elementit figurë që përmban shenja është transformuar në njëfarë mase dhe nuk duhet të konsiderohet në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së.</i>
--	--

2.2.3.2 Vlerësimi i marrëdhënies ndërmjet mallrave e shërbimeve dhe shenjës/publikun përkatës

a) Analiza e mallrave dhe shërbimeve

Vlerësimi nëse shenja është në kundërshtim me politikat publike ose me parimet e pranuar të moralit duhet të kryhet duke iu referuar perceptimit të asaj shenje nga publiku përkatës ⁽²³⁾.

Për këtë qëllim duhet të merren në analizë mallrat dhe shërbimet, pasi ata shërbejnë për të identifikuar së bashku publikun përkatës dhe perceptimin që ky publik ka për shenjen.

Përveç kësaj, Gjykata e Drejtësisë është shprehur se në shqyrtimin sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së, ndër të tjera, duhet të merret në konsideratë konteksti në të cilin publiku ka gjasë të hasë markën tregtare ⁽²⁴⁾, duke hamendësuar përdorimin normal të markës.

b) Publiku përkatës

- Nuk kufizohet te publiku i synuar

Për qëllimet e nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së **publiku përkatës jo me doemos kufizohet te publiku të cilit i drejtohen drejtpërdrejt mallrat dhe/ose shërbimet për të cilat është kryer aplikimi, por edhe persona të tjerë, të cilët edhe pa qenë të interesuar për këto mallra dhe/ose shërbime, mund ta hasin rastësisht këtë shenjë në jetën e përditshme** ⁽²⁵⁾.

Prandaj, vlerësimi i shenjës duhet **të bazohet në perceptimin e anëtarëve të publikut të cilët kanë gjasë ta hasin markën tregtare kudo që mund të gjenden mallrat dhe/ose shërbime.**

- Standardi i një personi të arsyeshëm me ndjeshmëri dhe prag tolerance mesatar

Perceptimi i shenjës nuk mund të bazohet në pjesën e publikut përkatës që nuk konstaton asgjë tronditëse dhe as në pjesën e publikut që mund të fyhet shumë lehtë. Përkundrazi, ai duhet të bazohet **në standardin e një personi me ndjeshmëri dhe pragje tolerance mesatare**. Kjo do të thotë se nuk mjafton nëse marka tregtare ka gjasë të fyejë vetëm një pakicë të vogël qytetarësh jashtëzakonisht puritanë. Në të kundërt, marka tregtare nuk duhet lejuar të regjistrohet thjesht për faktin se njësoj nuk do të fyente pakicën e vogël në ekstremin tjetër të spektrit që konsideron të pranueshme edhe paturpësinë e rëndë. Disa njerëz fyhen letë, ndërsa të tjerë as që tronditen fare. Prandaj, vlerësimi nëse shenja është në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit duhet të kryhet duke iu referuar standardeve dhe vlerave të qytetarëve të zakonshëm që ndodhen midis këtyre dy ekstremeve ⁽²⁶⁾.

- Interesi publik rreth regjistrimit të fjalëve fyese

Fakti që shumë njerëz nuk i konsiderojnë fyese disa fjalë ose i kanë përfshirë ato në fjalorin e tyre të përditshëm, nuk e ndryshon faktin që këto fjalë mund të perceptohen si fyese: ka një interes publik në të

⁽²³⁾ 20/09/2011, T-232/10 Coat of arms of the Soviet Union, EU:T:2011:498, § 50.

⁽²⁴⁾ 27/02/2020, C-240/18 P, Fack Ju Göhte, EU:C:2020:118, § 42.

⁽²⁵⁾ 05/10/2011, T-526/09, Paki, EU:T:2011:564, § 17-18 dhe 06/07/2006, EUIPO Grand Board R 495/2005-G, SCREW YOU, § 21 dhe 26.

⁽²⁶⁾ 06/07/2006, EUIPO BoA R 495/2005-G, SCREW YOU, § 21.

siguruarin që të mos lejohet regjistrimi i shenjave të përbëra nga fjalë fyese me të cilat mund të përballen konsumatorët, sidomos të miturit dhe të rinjtë.

c) Perceptimi i publikut përkatës

Pasi të jenë identifikuar mallrat, shërbimet dhe publiku përkatës, duhet të kryhet vlerësimi për mënyrën si do të perceptohet shenja nga publiku përkatës në lidhje me ato mallra dhe/ose shërbime. Ky perceptim mund të ndikohet nga mallrat dhe/ose shërbimet, nga gjuha e shenjës, nga konteksti dhe rrethanat specifike të Shqipërisë ose nga elementët dhe/ose faktorët specifikë të rastit individual ⁽²⁷⁾.

Për **politikat publike**, perceptimi i publikut i referohet të kuptuarit të domethënies së shenjës nga publiku përkatës dhe jo perceptimit nga publiku përkatës nëse shenja është në kundërshtim me politikat publike.

• Ndikimi i mallrave dhe/ose shërbimeve në perceptimin e shenjës

- Rastet në të cilat mallrat dhe/ose shërbimet nuk kanë peshë në vlerësim

Në disa raste, **kuptimi i shenjës dhe/ose mesazhi i përçarur prej saj janë kaq të fortë sa do të refuzoheshin si në kundërshtim me politikat publike ose me parimet e pranura të moralit, pavarësisht mallrave dhe/ose shërbimeve që janë subjekt i aplikimit** ⁽²⁸⁾.

E papranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
	Klasa 25: Veshje	<i>Elementi figurë në shenjë paraqet qartazi një anëtar të grupit anëtar të grupit terrorist të urrejtjes dhe epërsisë së të bardhëve Ku Klux Klan (KKK), për shkak të tunikës së bardhë me kapuç me emblemën e këtij grupi mbi të. Përveç kësaj, personi ka ngritur lart krahun e djathtë në mënyrë të tillë që ngjan me përshëndetjen naziste. Mesazhi i përçarur nga shenja është kaq i fortë dhe kaq thellësisht i lidhur me veprimet raciste dhe kriminale, sa në asnjë mënyrë nuk mund të merret si mesazh me nuanca. Prandaj, shenja do të konsiderohet, ndër të tjera, se është në kundërshtim me vlerat universale të BE-së, si dinjiteti i njeriut, liria, barazia dhe solidariteti siç janë shpallur në KDThBE dhe, për rrjedhojë, shenja është në kundërshtim me politikat publike dhe parimet e pranura të moralit, për të gjitha mallrat dhe shërbimet.</i>
ASIAN PENCIL DICK	Klasa 10: Lodrat e seksit	<i>Edhe pse publiku i synuar i lodrave të seksit hamendësohet të jetë shumë tolerant për shenjat që mbartin konotacion seksual, mesazhi i përçarur nga shenja është racist, me stereotip për një grup etnik dhe i ngarkuar me konotacion seksual. Është kaq fyes dhe denigrues sa shenja do të konsiderohet, më së paku, në kundërshtim me disa nga vlerat themelore të BE-së, si dinjiteti i njeriut, mosdiskriminimi, gjithëpërfshirja dhe barazia, siç janë shpallur në KDThBE. Prandaj, ajo do të ishte në kundërshtim me parimet e pranura të moralit dhe politikat publike së bashku për të gjitha mallrat dhe shërbimet.</i>

⁽²⁷⁾ 27/02/2020, C-240/18 P, Fack Ju Göhte, EU:C:2020:118, § 40 dhe § 42-43.

⁽²⁸⁾ 05/10/2011, T-526/09, Paki, EU:T:2011:564, § 15.

- Rastet në të cilat mallrat dhe/ose shërbimet ndikojnë në perceptimin e publikut përkatës

Në disa raste, mallrat e shërbimet si dhe konteksti në të cilin ofrohen ato, mund të ndikojnë në perceptimin e publikut përkatës, në kuptimin që mund të theksojnë papranueshmërinë e mesazhit të përçar nga shenja në aspektin e politikave publike dhe/ose parimeve të pranuar të moralit. Ky është rasti kur publiku i gjerë, sidomos fëmijët dhe të rinjtë, mund të ekspozohen në mënyrë të përditshme ndaj mallrave dhe/ose shërbimeve (në dyqane, nga reklamat e shfaqura në televizion etj.).

Mallrat e shërbimet dhe konteksti <u>theksojnë</u> papranueshmërinë e shenjës në aspektin e politikave publike dhe parimeve të pranuar të moralit		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
KILL THEM ALL	Klasa 41: Shërbime dëfrimi për fëmijët	Fjalët “KILL THEM ALL” përçojnë një mesazh që mund të kuptohet si nxitje për të vrarë. Në këtë rast, shërbimet për të cilat është bërë aplikimi, të cilat u drejtohen fëmijëve, theksojnë papranueshmërinë e elementëve fjalë dhe ka më shumë të ngjarë që shenja të perceptohet si nxitje për të kryer një krim.
AUSCHWITZ MEMORIES	Klasa 41: Shërbime të parqeve të zbavitjes	“Auschwitz” ishte një kamp përqendrimi nazist i ndodhur në Poloninë e pushtuar nga Gjermania gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në këtë rast, përdorimi i këtij emri në lidhje me parqet e zbavitjes thekson papranueshmërinë e elementëve fjalë dhe ka më shumë të ngjarë që shenja të perceptohet si banalizim i tragjedisë dhe i viktimave të saj.

Në të kundërt, në raste të tjera, mallrat e shërbimet dhe konteksti në të cilin ofrohen ata, mund të eliminojnë ose neutralizojnë papranueshmërinë e mesazhit të përçar nga shenja në aspektin e politikave publike dhe/ose parimeve të pranuar të moralit. Ky është rasti, për shembull, i mallrave dhe/ose shërbimeve që shiten vetëm në dyqane seksi të licencuar, ku mund të jetë i përshtatshëm një qëndrim më i çlirët ⁽²⁹⁾.

Mallrat e shërbimet dhe konteksti <u>eliminojnë ose neutralizojnë</u> papranueshmërinë e shenjës në aspektin e politikave publike dhe/ose parimeve të pranuar të moralit		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
KILL THEM ALL	Klasa 5: Insekticide	Fjalët “KILL THEM ALL” përçojnë një mesazh që mund të kuptohet si nxitje për të vrarë. Në këtë rast, mallrat subjekt i aplikimit neutralizojnë papranueshmërinë e mesazhit të përçar dhe shenja ka më shumë të ngjarë të perceptohet se i referohet vetëm vrasjes së insekteve.
AUSCHWITZ MEMORIES	Klasa 41: Muzetë	“Auschwitz” ishte një kamp përqendrimi nazist i ndodhur në Poloninë e pushtuar nga Gjermania gjatë Luftës së Dytë Botërore. Shërbimet për të cilat është bërë aplikimi eliminojnë çdo mesazh fyes ose tronditës dhe shenja ka më shumë të ngjarë të perceptohet në kontekstin e prezantimit objektiv të ngjarjeve historike specifike, për qëllime të edukimit dhe rritjes së ndërgjegjësisimit të vizitorëve.

- **Fushëveprimi gjuhësor dhe gjeografik**

Fushëveprimi gjuhësor dhe gjeografik i shenjës duhet të merret në analizë. Vlerësimi nëse shenja është në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së duhet të kryer në lidhje me publikun përkatës që

⁽²⁹⁾ 06/07/2006, EUIPO BoA R 495/2005-G, SCREW YOU, § 21.

mund ta kuptojë dhe do të përballej me shenjë.

Për këtë vlerësim, **pavarësisht se publiku përkatës mund të kuptojë një shenjë në gjuhë të huaj, niveli i ndjeshmërisë së tij mund të jetë i ndryshëm nga ai i folësve që atë gjuhë e kanë gjuhë amtare** ⁽³⁰⁾. Për shembull, perceptimi i një fjalie në anglisht nga një folës që nuk e ka anglishten gjuhë amtare jo doemos është i njëjtë me një folës që këtë gjuhë e ka amtare.

Sa i takon fushëveprimit gjeografik, të kuptuarit e gjuhëve nuk kufizohet rreptësisht nga kufijtë gjeografikë. Mund të ndodhë që, për arsye historike, kulturore ose tregtie ndërkufitare, disa fjalë të një gjuhe të caktuar të përhapen dhe të kuptohen gjerësisht nga publiku i përgjithshëm në Shqipëri.

- **Kontekstet dhe rrethanat e veçanta të cilat mund të kenë ndikim në perceptimin e shenjës**

Në fund, ka edhe kontekste dhe rrethana të veçanta të një pjese të Shqipërisë që janë të rëndësishme për të vlerësuar perceptimin e publikut dhe, nëse është me vend, mund të merren parasysh në vlerësimin e politikave publike dhe parimeve të pranura të moralit të bashku, pasi këto mund të pengojnë ose ndihmojnë regjistrimin e shenjes. Këta elementë mund të jenë, pa kufizim, si më poshtë vijon.

- **Konteksti shoqëror**, për shembull larmia gjuhësore, historike, fetare ose filozofike në atë pikë të caktuar në kohë. Ky kontekst ndikon në perceptimin e publikut përkatës dhe për pasojë atë që do të konsiderohet në kundërshtim me politikat publike ose me parimet e pranura të moralit në atë territor të Shqipërisë.

Për shembull, ngjarjet botërore si krizat e refugjatëve, fuqizimi i politikave të krahut të djathtë ekstrem, riklasifikimi i veprave penale të lidhura me drogat etj.

- **Opinionet publikë i përhapur gjerësisht** (qoftë ky publiku i synuar apo publiku i gjerë). Kjo gjë mund të përcaktohet duke marrë në konsideratë, për shembull, artikuj nga librat, shtypi dhe burime të tjera që bëjnë të mundur të provohet opinionet publikë mbizotërues.
- **Mënyra si ka reaguar në të shkuarën publiku përkatës ndaj kësaj shenje ose shenjave të ngjashme me të** ⁽³¹⁾. Pavarësisht se mungesa e kundërshtisë duhet të merret në konsideratë për të përcaktuar si e percepton publiku përkatës markën tregtare për të cilën është bërë aplikimi, fakti se kjo shenjë ose një e ngjashme me të i është paraqitur më parë publikut përkatës pa hasur kundërshti, jo doemos nënkupton se shenja nuk është në kundërshtim me politikat publike ose me parimet e pranura të moralit ⁽³²⁾.

⁽³⁰⁾ 27/02/2020, C-240/18 P, Fack Ju Göhte, EU:C:2020:118, § 68.

⁽³¹⁾ “Ashtu siç e vëren Avokati i Përgjithshëm në pikën 94 të Opinionit të tij, te këta faktorë hyjnë suksesi i madh i komedisë me të njëjtin emër në publikun e gjerë gjermanishtfolës, fakti që titulli i saj nuk duket se ka shkaktuar kundërshti si dhe fakti që gasja e të rinjve në të është lejuar dhe se Instituti Goethe – i cili është instituti i Republikës Federale Gjermane për kulturën që vepron në të gjithë botën dhe i ngarkuar, ndër të tjera, me përhapjen e gjuhës gjermane – e përdor për qëllime edukative”. 27/02/2020, C-240/18 P, Fack Ju Göhte, EU:C:2020:118, § 52.

⁽³²⁾ 05/10/2011, T-526/09, Paki, EU:T:2011:564, § 36.

- **Në kontekstin e politikave publike, vëzhgimet e bëra nga vendet e treta ose Shtetet e tjera Anëtare**, nëse është e përshtatshme, mund të konsiderohen për të vlerësuar perceptimin e publikut, me kusht që këto vëzhgime (sa i takon reagimit pozitiv ose negativ ndaj një shenje ose ndikimit pozitiv ose negativ të një shenje përkatëse si markë tregtare) të jenë në pajtim me vlerat dhe parimet shqiptare të lartpërmendura si dhe me marrëveshjet ligjore të nënshkruara në kontekstin e traktateve dhe konventave ndërkombëtare ⁽³³⁾.
- **Sepse parimet e pranuar të moralit, legjislacioni dhe praktikat administrative** mund të jenë tregues se çfarë është moralisht e pranueshme ose e papranueshme për pjesëtarët e një shoqërie të caktuar në një moment të caktuar (p.sh. standardet e transmetimeve audiovizive). Megjithatë, një shenjë nuk duhet të refuzohet (si në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit) vetëm për shkak se bie në konflikt me legjislacionin dhe praktikën kombëtare. Legjislacioni dhe praktikat administrative konsiderohen jo për shkak të vlerës së tyre normative, por si provë e mundshme e fakteve që kanë të bëjnë me vlerat morale dhe standardet themelore të pranuar nga një shoqëri.

2.2.3.3 Përcaktimi i burimeve të besueshme dhe objektive nga të cilat mund të vërtetohen politikat publike

Kur analizohet nëse një shenjë është në kundërshtim me politikat publike, duhet bërë një vlerësim për të përcaktuar, nga burime të besueshme dhe objektive, normën themelore, parimin dhe/ose vlerën e shkelur.

Në këtë aspekt, **duhet** të merret në konsideratë lista e mëposhtme joshteruese e burimeve:

- parimet e përgjithshme të ligjit,
- traktatet dhe konventat ndërkombëtare,
- traktatet e BE-së,
- legjislacioni i BE-së,
- praktika gjyqësore e BE-së,
- legjislacioni i Shtetit Anëtar në fuqi dhe praktika gjyqësore e Shtetit Anëtar ⁽³⁴⁾.

Nëse është e përshtatshme, mund të konsiderohet lista joshteruese e burimeve si më poshtë vijon:

- udhëzimet qeveritare dhe administrative ose kodet e sjelljes (p.sh. distancimi social lidhur me COVID-19).
- çështjet e sigurisë dhe shëndetit publik që nuk janë artikuluar në legjislacion (p.sh. rekomandimet e qeverisë dhe rekomandimet profesionale të mbështetura shkencërisht).

Megjithatë, nuk mjafton që shenja të bjerë ndesh me diçka të përfshirë në burimet e lartpërmendura; ajo duhet edhe të prekë një interes që Shqipëria e konsideron themelor në pajtim me sistemin e vlerave të veta ⁽³⁵⁾ ⁽³⁶⁾.

⁽³³⁾ Shembuj të traktateve dhe konventave ndërkombëtare: (1) Rezoluta 2178 (2014) e Këshillit të Sigurimit për luftëtarët e huaj terroristë. Për shembull, një markë tregtare në emrin e nuses së xhihadit të ISIS (si Shamima Begum – së cilës iu hoq shtetësia e MB-së) do të ishte e papranueshme; (2) Konventa për "Për ndalimin e përdorimit, të magazinimit, të prodhimit dhe të transferimit të minave kundër personit (MKP) dhe për shkatërrimin e tyre" (e njohur edhe si Konventa "Për ndalimin e minave kundër personit", Konventa e Otavës, ose Traktati "Për ndalimin e minave") – prandaj një markë tregtare që lavdëron minat tokësore do të ishte e papranueshme; (3) Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope; (4) Konventa e Këshillit të Evropës "Për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit dhe abuzimit seksual" e njohur edhe si "Konventa e Lanzarotes"; (5) Konventa e Këshillit të Evropës "Për veprimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore"; (6) Konventa "Për statusin e refugjatit" (1951), traktat shumëpalësh i Kombeve të Bashkuara; (7) Konventa "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara" (2006), Konventë e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut.

⁽³⁴⁾ Gjatë vlerësimit të aplikimeve kombëtare për markat tregtare.

⁽³⁵⁾ 12/12/2019, T-683/18, CANNABIS STORE AMSTERDAM (fig.), EU: T:2019:855, §73-75.

⁽³⁶⁾ Interesat e BE-së mund të gjenden këtu: https://european-union.europa.eu/principles-countries-history/principles-and-values/aims-and-values_en dhe në nenin 3 të Traktatit të Lisbonës.

2.2.3.4 Identifikimi i vlerave morale dhe standardeve themelore

Kur analizohet nëse shenja është në kundërshtim me parimet e pranura të moralit, me vlerat morale dhe standardet themelore të pranura nga një shoqëri, kjo gjë nuk mund të pikaset jashtë normave dhe kontekstit shoqëror. Identifikimi i tyre duhet të bazohet në informacione të verifikueshme dhe jo vetëm mbi baza teorike ose mbi logjikën e pastër. **Shqyrtuesit e aplikimeve duhet të japin një deklaram objektive të arsyeve dhe, aty ku është e mundur, të mbështeten në burime të pavarura dhe të besueshme për të mbështetur vendimet e tyre.**

Zyra e Pronësisë Intelktuale nuk është e detyruar të kryejë anketime të thelluara empirike për të përcaktuar parimet e pranura të moralit kundrejt një shenje të caktuar. Gjithsesi, vendimet duhet të mbështeten në një kontekst specifik shoqëror dhe nuk mund të anashkalojnë provat faktike, të cilat ose pohojnë ose mund të hedhin dyshime mbi atë që përputhet ose jo me parimet e pranura të moralit brenda një shoqërie të dhënë në një kohë të caktuar ⁽³⁷⁾.

Për të hedhur poshtë kundërshtimin e shqyrtuesit lidhur me parimet e pranura të moralit, aplikuesi mund të paraqesë prova për të dhënë një kundërprovë të reagimit të hamendësueshëm të publikut përkatës ndaj shenjës. Kjo provë ka lidhje të fortë me rrethanat e faktit të secilit rast. Prandaj, është e pamundur të hartohet një listë shteruese e provave ose një listë e provave të rekomanduara që mund të paraqitet në secilin rast më vete. Palët mund të zgjedhin lirisht provat që ato dëshirojnë të paraqesin para autoriteteve përkatëse, duke përfshirë Zyrën e Pronësisë Intelktuale, dhe çështja e vlerësimit të saj mbetet gjithmonë në vetëgjykimin e tyre. Megjithatë, si një formë udhëzimi jodetyrues, Praktika e Përbashkët/ Rekomandime të Përbashkëta CP12 – *Provat në procedurat e apelimit të Markave Tregtare: depozitimi, struktura dhe prezantimi i provave dhe trajtimi i provave konfidenciale* ⁽³⁸⁾ mund të shërbejë si pikë reference për të gjitha palët e interesuara, të cilat mund të përdorin rekomandimet e CP12 të cilat ato i konsiderojnë të dobishme dhe të zbatueshme një një rast të veçantë që lidhet me këtë temë.

2.3 Mbivendosja e politikave publike dhe e parimeve të pranura të moralit

Siç përmendet në seksionin 2.2, politikat publike dhe parimet e pranura të moralit janë dy koncepte të ndryshme që shpesh mbivendosen. Kjo do të thotë se mospranimi mund të vijë njëkohësisht për shkak të politikave publike dhe të parimeve të pranura të moralit (p.sh. një markë tregtare mund të perceptohet nga publiku përkatës si drejtpërdrejt në kundërshtim me vlerat morale dhe standardet themelore të pranura nga shoqëria shqiptare në një moment të dhënë në kohë dhe, në të njëjtën kohë, mund të mohojë ose nxitë, lavdërojë, banalizojë ose justifikojë shkeljen e normave, parimeve dhe/ose vlerave themelore në shoqërinë shqiptare). Për këtë arsye, me këtë motivacion, duhet kryer një shqyrtim paralel i politikave publike dhe parimeve të pranura të moralit për të përcaktuar nëse zbatohet njëra prej tyre ose të dyja bashkë.

Këtu më poshtë janë disa skenarë në të cilët, në varësi të rrethanave të rastit, shenja mund të jetë si në kundërshtim me politikat publike ashtu edhe me parimet e pranura të moralit ⁽³⁹⁾.

- **Shenjat e lidhura me të drejtat e njeriut:** Regjistrimi i shenjave që mund të perceptohen se bien ndesh dhe/ose nxitin, lavdërojnë, banalizojnë, ose justifikojnë shkeljen e të drejtave të njeriut, të cilat janë parime dhe vlera themelore të Shqipërisë, kështu që ato mund të jenë në kundërshtim me vlerat morale dhe standardet themelore të çdo shoqërie. Për shembull, këtu mund të hyjnë mesazhet diskriminuese; shenjat që përmbajnë ose mund të perceptohen si thirrje për urrejtje për çfarëdo lloji arsye (p.sh. për shkak të racës, gjinisë, seksit, kulturës, fesë); dhe shenjat kundër së drejtës për jetën, dinjitetit të njeriut ose integritetit fizik.

⁽³⁷⁾ Opinioni i Avokatit të Përgjithshëm Bobek, dhënë më 2 korrik 2019 në çështjen 27/02/2020, C-240/18 P, Fack Ju Göhte, EU:C:2020:118, § 83.

⁽³⁸⁾ <https://tmdn.org/#!/practices/1819736>

⁽³⁹⁾ Shembujt për secilin prej këtyre skenarëve janë dhënë në seksionin 2.5.

- **Shenjat që lidhen me lëndët e paligjshme të cilat shënjestrojnë grupet e cenueshme (p.sh. drogat ose lëndët e paligjshme të cilat janë të ndaluara për të miturit):** Regjistrimi i shenjave që lavdërojnë, banalizojnë ose nxitin konsumimin ose përdorimin e lëndëve të paligjshme dhe që shënjestrojnë grupet e cenueshme (p.sh. të rinjtë dhe/ose fëmijët) mund të bjerë ndesh me normat, parimet dhe vlerat themelore të Shqipërisë dhe cenojnë një interes themelor të Shqipërisë (p.sh. shëndetin publik). Në të njëjtën kohë, ato mund të jenë në kundërshtim me vlerat morale dhe standardet e shoqërisë shqiptare, duke pasur parasysh se ka një interes publik në të siguruarit që grupet e cenueshme të mos përballen me shenja dhe/ose mesazhe që mund t'i rrezikojë ato.
- **Shenjat që lidhen me një fe:** Regjistrimi i shenjave që përmbajnë një simbol fetar, në varësi të kontekstit, mund të ofendojë jo vetëm besimtarët e asaj feje, por edhe besimtarët e një feje tjetër ose ata që nuk besojnë fare. Besimet fetare duhet të trajtohen me respekt si çështje e politikave publike, duke qenë se liria e besimit fetar është një e drejtë themelore e garantuar nga KDTHBE-ja dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe konsiderohet si një prej themeleve të një shoqërie demokratike ⁽⁴⁰⁾. Duhet t'i jepet peshë edhe dispozitave të ndryshme në legjislacion, disa prej të cilave ndalojnë regjistrimin e shenjave me vlerë të lartë simbolike si markë tregtare, sidomos të shenjave fetare. Në varësi të rrethanave, edhe morali mund të jetë problem.
- **Shenjat që lidhen me veprimtaritë/organizatat kriminale (p.sh. me terrorizmin dhe mafian):** Regjistrimi i shenjave që lidhen me veprimtaritë dhe/ose organizatat kriminale, në varësi të kontekstit, mund të konsiderohet se bien ndesh me politikat publike dhe parimet e pranuar të moralit. Këto veprimtari/organizata janë në kundërshtim me parimet etike dhe morale të njohura jo vetëm në Shqipëri, por në të gjitha shoqëritë demokratike, duke qenë një prej kërcënimeve më serioze për interesat themelore të shoqërisë dhe për ruajtjen e paqes dhe rendit shoqëror. Këto shenja bien ndesh me vlerat universale të pandashme mbi të cilat është themeluar BE-ja: dinjteti i njeriut, liria, barazia dhe solidariteti si dhe parimet e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, ashtu siç janë shpallur në KDTHBE, ku e drejta për jetën dhe integritetin fizik qëndrojnë si vlerat kryesore themelore pa të cilat nuk mund të gëzohen të drejtat e tjera. Edhe vlerat morale themelore të Shqipërisë pengojnë regjistrimin e këtij lloji shenjash si marka tregtare dhe shfrytëzimin e tyre tregtar, pasi regjistrimi i këtyre markave tregtare do të fyente dhe trondiste thellësisht jo vetëm viktimat dhe të afërmit e tyre, por edhe çdo person që i ka të vetat këto vlera universale ⁽⁴¹⁾.

2.4 Liria e shprehjes

Në pajtim me praktikën gjyqësore të BE-së, **liria e shprehjes duhet patjetër të merret parasysh** kur merret në analizë nëse shenja është në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së. Në veçanti, Gjykata e Drejtësisë shpreh se:

... liria e shprehjes, e shenjtëruar në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, duhet ... të merret në konsideratë kur zbatohet neni 7, paragrafi 1, germa "f" i Rregullores nr. 207/2009. Ky konstatim pohohet, për më tepër, nga deklamimi 21 i Rregullores nr. 2015/2424, e cila ndryshon Rregulloren nr. 207/2009 dhe nga deklamimi 21 i Rregullores 2017/1001, ku të dyja bashkë theksojnë shprehimisht nevojën për të zbatuar këto rregullore në atë mënyrë që të garantohet respektimi i plotë i të drejtave dhe lirive themelore, sidomos i lirisë së shprehjes ⁽⁴²⁾.

⁽⁴⁰⁾ 05/09/2012, çështjet e bashkuara C-71/11 dhe C-99/11, Bundesrepublik Deutschland k. Y dhe Z, EU:C:2012:518, § 57.

⁽⁴¹⁾ 15/03/2018, T-1/17, La Mafía SE SIENTA A LA MESA (fig.), EU:T:2018:146, § 35, 36, 47; EUIPO BOA, R 176/2004-2, Bin Ladin, §17.

⁽⁴²⁾ 27/02/2020, C-240/18 P, Fack Ju Göhte, EU:C:2020:118, § 56.

Ndikimi i këtij parimi në vlerësimin e nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së aktualisht nuk është rregulluar në ligjin për markat tregtare në Shqipëri ose në BE. Për më shumë informacion për “burimet ligjore potencialisht të rëndësishme” për zbatimin e nenit 10 të KEDNj-së dhe të nenit 11 të KDThBE-së, lutemi shihni Shtojcën (p.sh. shembuj nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Përgjithshme, Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut).

2.5 Shenjat që mund të bien në fushëveprimin e nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së

Për të ndihmuar vlerësimin e kësaj arsyeje për refuzim, është krijuar një listë joshteruese me grupe shenjash që mund të bien në veprimin e nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së, ku jepen shembuj ilustrues. Kjo listë nuk ka për qëllim të mbulojë të gjitha shenjat që mund të bien nën këtë arsye për refuzim, as nuk nënkupton se një shenjë mund të mos përfshihet në më shumë se një grup. **Pavarësisht se vlerësimi nëse një shenjë është në kundërshtim me politikat publike, me parimet e pranuar të moralit ose me të dyja bashkë do të kryhet rast pas rasti, duke konsideruar nivelin normal të ndjeshmërisë dhe tolerancës së publikut përkatës në juridiksion si dhe të gjitha rrethanat specifike të Shqipërisë dhe rastin e veçantë, parimet e përfshira në këtë pjesë të Dokumentit të Praktikës shërben si orientim për të vlerësuar shenjat në kuadrin e kësaj dispozite në mënyrë të parashikueshme.** Shembujt e përfshirë në këtë kapitull synojnë të ilustronjë parimet e shpjeguara në secilin prej tyre. Prandaj, ata duhet të konsiderohen gjithmonë në lidhje me grupin përkatës dhe parimin të cilit i referohen, duke mbajtur në mendje konsideratat e përgjithshme të përfshira në seksionin 1.3 të këtij dokumenti.

Për grupet e përfshira në këtë kapitull, duhet të hamendësohet se **publiku përkatës në të gjithë shembujt e dhënë e kupton anglishten njësoj si ata që e kanë anglishten gjuhë amtare.** Për më tepër, shembujt e dhënë këtu janë treguar vetëm për qëllime të vlerësimit të nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së, prandaj fakti që disa prej tyre do të ishin të pranueshëm sipas kësaj dispozite, nuk do të thotë se nuk mund të refuzohen për motive të tjera refuzimi.

2.5.1 Shenjat që përmbajnë/lidhen me lëndë të paligjshme

Ky grup përmban, pa kufizim, shenja ku elementët fjalë ose figurë ose kombinimi i tyre, përmban dhe/ose është e lidhur me:

- lëndë të paligjshme në Shqipëri, në BE dhe/ose në një ose më shumë Shtete Anëtare ose lëndë të përdorura në mënyrë të paligjshme sipas ligjeve përkatëse në Shqipëri, BE ose në një Shtet Anëtar, si heroina, kristalet e metamfetaminës, droga “crack”, ekstazi ose disa halucinogjenë, duke përfshirë LSD-në, kanabisin, opioidet, ketaminën ose amfetaminat; ose
- lëndë të ligjshme të përdorura në mënyrë të paligjshme si zamkë ose naftë, të cilat shiten ligjërisht por nuk duhen përdorur jashtë synimit të tyre, për shembull, për të thithur tymra ose për konsum alkooli nga të miturit.

Në parim, këto shenja kanë gjasë të konsiderohen **në kundërshtim me politikat publike** sa herë ato **qartësisht nxitin, inkurajojnë, lavdërojnë dhe/ose banalizojnë konsumin rekreativ këtyre lëndëve.** Shenja mund të jetë edhe **në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit** nëse mund të **perceptohet si ofenduese kundrejt vlerave dhe standardeve morale** të shoqërisë në Shqipëri, në një Shtet Anëtar të BE-së dhe/ose në BE.

Këto shenja do të kuptohen se bien ndesh me normat, parimet dhe vlerat themelore të shoqërive në Shqipëri dhe në BE, të cilat sipas politikave të BE-së për drogat ⁽⁴³⁾ synojnë, ndër të tjera, të mbrojnë dhe përmirësojnë shëndetin publik si dhe të luftojnë pasojat e dëmshme që krijohen nga përdorimi i këtyre lëndëve.

⁽⁴³⁾ https://ec.europa.eu/home-affairs/policies/internal-security/organised-crime-and-human-trafficking/drug-policy_en

Sa i takon drogave ose lëndëve të paligjshme të përdorura në mënyrë të paligjshme, rëndësia e këtyre interesave themelore theksohet edhe më shumë nga:

- Neni 83 i Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian (TFBE), sipas të cilit trafikimi i drogave të paligjshme është një prej fushave me krime veçanërisht të rënda me përmasë ndërkufitare, në të cilën mund të ndërhyjë legjislatura e BE-së.
- Nënparagrafi i tretë i paragrafit 1 të nenit 168 të TFBE-së, sipas të cilit BE-ja plotëson veprimin e Shteteve Anëtare në uljen e dëmeve në shëndet të shkaktuara nga droga, duke përfshirë informacionin dhe parandalimin ⁽⁴⁴⁾.

E papranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
	Klasa 25: Veshje	<i>Kombinimi i elementit fjalë “COCAINE” (drogë rekreative që është e paligjshme në Shqipëri dhe në BE) dhe i elementit figurë të një superheroi do të perceptohet nga publiku i përgjithshëm që e has shenjën në jetën e përditshme se po përçon një mesazh pozitiv për pasojat e konsumit të kokainës dhe po lavdëron dhe/ose banalizon përdorimin e drogave. Më së paku, kjo bie ndesh me interesat themelore të Shqipërisë dhe BE-së për mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit publik si dhe për luftën ndaj pasojave të dëmshme të drogave të paligjshme, siç parashikohet në nenin 83 dhe nenin 168, paragrafi 1, të TFBE-së. Prandaj, shenja është në kundërshtim me politikat publike. Shenja është në kundërshtim edhe me parimet e pranuar të moralit për shkak se banalizon konsumin e kokainës në atë mënyrë sa shkakton fyerje, pasi konsumi i kësaj lënde shkakton dëme serioze në shëndet. Prandaj, inkurajimi i përdorimit të saj do të perceptohej se bie ndesh me vlerat morale dhe standardet e shoqërisë në Shqipëri, në një Shtet Anëtar të veçantë, ose sipas rastit, në BE.</i>
	Klasa 25: Veshje	<i>Konsumi i kanabisit është i paligjshëm në Shqipëri dhe/ose mund të jetë i ligjshëm në disa Shtete Anëtare. Mesazhi i përçar nga shenja “LOVE, PEACE AND GET STONED”, shoqëruar me elementët figurativë të përbërë nga gjethet e kanabisit dhe tymi, do të perceptohet nga publiku i përgjithshëm që e has shenjën në jetën e përditshme se në mënyrë të qartë po përkrah, po lavdëron dhe/ose banalizon përdorimin e kësaj lënde. Kjo bie ndesh me interesat themelore të Shqipërisë dhe BE-së për mbrojtjen dhe përkrahjen e shëndetit publik si dhe për luftën ndaj pasojave të dëmshme të drogave të paligjshme, siç parashikohet në nenin 83 dhe nenin 168, paragrafi 1, të TFBE-së. Prandaj, shenja është në kundërshtim me politikat publike. Shenja mund të jetë edhe kundër parimeve të pranuar të moralit për shkak se banalizon dëmet ose konsumin me tepri të kanabisit. Prandaj, inkurajimi i abuzimit me të mund të perceptohet se bie ndesh me vlerat morale dhe standardet e shoqërisë në Shqipëri, në një Shtet Anëtar të veçantë, ose sipas rastit, në BE.</i>

⁽⁴⁴⁾ 12/12/2019, T-683/18, CANNABIS STORE AMSTERDAM (fig.), EU: T:2019:855, §74-75.

WEED PARTY	Klasa 41: Festivale	<i>Elementi fjalë “WEED” ka kuptime të ndryshme. Këto kuptime mund t’i referohen “një bime të egër që rritet aty ku nuk duhet, sidomos ndër drithërat ose bimët e kopshteve” ose “kanabisit të paligjshëm”. Në kombinim me “PARTY” dhe në lidhje me festivalet, shenja do të perceptohet nga nga publiku i përgjithshëm që e has shenjën në jetën e përditshme se në mënyrë të qartë po përkrah, po lavdëron dhe/ose banalizon konsumin e paligjshëm/rekreativ të kanabisit. Kjo bie ndesh me interesat themelore të Shqipërisë dhe BE-së për mbrojtjen dhe përkrahjen e shëndetit publik si dhe për luftën ndaj pasojave të dëmshme të drogave të paligjshme, siç parashikohet në nenin 83 dhe nenin 168, paragrafi 1, të TFBE-së. Prandaj, shenja është në kundërshtim me politikat publike. Shenja është edhe kundër parimeve të pranuara të moralit për shkak se banalizon dëmet ose konsumin me tepri të kanabisit. Prandaj, inkurajimi i abuzimit me të mund të perceptohet se bie ndesh me vlerat morale dhe standardet e shoqërisë në Shqipëri, në një Shtet Anëtar të veçantë, ose sipas rastit, në BE.</i>
------------------------------	----------------------------	---

Përveç kësaj, shenjat që i referohen një **lënde të ligjshme të përdorur në mënyrë të tillë që të jetë e dëmshme (për shkak se kërcënon rëndë jetën, shëndetin ose mirëqenien e publikut të synuar ose të publikut të gjerë) ose në një mënyrë që është e paligjshme në Shqipëri, në BE ose në një Shtet Anëtar të BE-së**, gjithashtu kanë gjasë të konsiderohen **në kundërshtim me politikat publike** sepse ato banalizojnë ose normalizojnë veprimet ose veprimtaritë e dëmshme që prekin interesat themelore të Shqipërisë dhe BE-së për mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit publik, sipas parashikimeve të nenit 168, paragrafi 1, të TFBE-së. Këto shenja mund të jenë edhe **në kundërshtim me parimet e pranuara të moralit** kur ato perceptohen si fyese për vlerat dhe standardet morale të shoqërisë në Shqipëri, në një Shtet Anëtar të BE-së dhe/ose në BE.

E papranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
	Klasa 18: Çanta	Kombinimi i një njeriu që thith avujt e zamkës me parullën "LIFE IS GOOD" sugjeron fort se të thithësh avujt e zamkës e bën jetën "të mirë" në njëfarë mënyre. Edhe pse zamka në vetvete nuk është e paligjshme, ky mesazh do të perceptohet nga publiku i përgjithshëm si inkurajues i përdorimit të zamkës për efektet e saj psikotrope. Është fakt mëse i ditur se "thithja me hundë e zamkës" përbën rrezik të madh për shëndetin dhe konsiderohet si pararendës i abuzimit me droga të tjera të paligjshme. Për më tepër, "thithja me hundë e zamkës" është konsideruar për vite të tëra si problem real dhe i përhapur gjerësisht ndër fëmijët dhe adoleshentët, një grup ky që mund të ndikohet në mënyrë të veçantë nga mesazhi i shenjës se thithja e zamkës përmirëson cilësinë e jetës. Për rrjedhojë, një mesazh i tillë bie ndesh me interesat themelore të Shqipërisë dhe BE-së për të mbrojtur dhe përmirësuar shëndetin publik, sipas parashikimeve të nenit 168, paragrafi 1, të TFBE-së. Prandaj, shenja është në kundërshtim me politikat publike. Shenja është edhe në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit për shkak se mund të perceptohet se inkurajon përdorimin e papërshtatshëm të zamkës, për pasojë është fyese.

Për më tepër, nëse një shenjë e përfshirë në këtë grup aplikohet në mallra dhe/ose shërbime, publiku përkatës i të cilave është një grup i cënueshëm si fëmijët, ka më shumë të ngjarë që shenjat të konsiderohen edhe në kundërshtim me politikat publike dhe/ose parimet e pranuar të moralit, sepse vënia në rrezik e mirëqenies së fëmijëve bie ndesh me interesat themelore të Shqipërisë dhe BE-së për të mbrojtur dhe përmirësuar shëndetin e fëmijëve, gjithashtu është imorale.

E papranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
ALCOHOL HERO	Klasa 28: Lodra	Shenja i referohet një lënde (alkoolit), e cila lejohet për personat në moshë madhore (d.m.th. 18 vjeç në Shqipëri dhe ndërmjet 16 - 20 vjeç në varësi të Shtetit Anëtar të BE-së). Mallrat për të cilat është bërë aplikimi u drejtohen fëmijëve, të cilët e kanë të ndaluar të konsumojnë alkool në Shqipëri dhe në të gjithë BE-në. Përveç kësaj, dëmi i shkaktuar nga alkooli është shqetësim madhor për shëndetin publik në Shqipëri dhe në BE. Kombinimi i fjalëve "HERO" dhe "ALCOHOL" në lidhje me mallrat në të cilat aplikohet shenja mund të perceptohet se përkrah, inkurajon, lavdëron dhe/ose banalizon konsumin e një lënde të paligjshme për fëmijët, gjë që bie ndesh me interesat themelore të Shqipërisë dhe BE-së për të mbrojtur dhe përmirësuar shëndetin publik, si dhe për të luftuar pasojat e dëmshme të krijuara nga përdorimi i drogave, sipas parashikimeve të nenit 168, paragrafi 1, të TFBE-së. Prandaj, shenja është në kundërshtim me politikat publike. Për më tepër, duke konsideruar se ekziston një interes publik në garantimin që grupet e cënueshme të mos

		<i>përballen me shenja dhe/ose mesazhe që mund t'i vënë në rrezik, shenja është në kundërshtim edhe me parimet e pranuar të moralit.</i>
--	--	--

Megjithatë, kur përbërja në tërësi e shenjës e bën të qartë se ajo nuk do të perceptohej nga publiku përkatës se përkrah, inkurajon, lavdëron dhe/ose banalizon konsumin për argëtim të një lënde të paligjshme ose të një lënde të ligjshme në mënyrë të paligjshme ose kur shenja përçon një mesazh kundër përdorimit të këtyre lëndëve, shenja nuk do të konsiderohet si në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së.

E pranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
HEROIN KILLS - KILL HEROIN	Klasa 44: Shërbime për trajtimin e varësisë	<i>Elementët fjalë “HEROIN KILLS - KILL HEROIN” në lidhje me “shërbimet për trajtimin e varësisë” do të perceptohet qartë nga publiku përkatës se përkrah luftën ndaj drogave, në pajtim me politikat për mbrojtjen e shëndetit dhe mbrojtjen civile, të cilat mbulohen nga normat themelore. Prandaj, pavarësisht se shenja përmban elementin fjalë “heroin”, ajo nuk është e papranueshme sipas kësaj arsyeje për refuzim.</i>
	Klasa 3: Krem duarsh	<i>Kombinimi i elementit fjalë “HEMP LIFE” dhe i elementit figurë që i referohet karakteristikave gjenetike të një bime, nuk përçon ndonjë mesazh i cili do të perceptohej se përkrah, inkurajon, lavdëron dhe/ose banalizon përdorimin ose konsumin e paligjshëm/për zbavitje të lëndës së paligjshme. Prandaj, pavarësisht se shenja përmban elementin fjalë “hemp” ⁽⁴⁵⁾, ajo nuk do të ishte e papranueshme sipas kësaj arsyeje për refuzim pasi në këtë kontekst ajo mund të kuptohet si “industrial hemp”, i cili nuk zotëron veti narkotike.</i>

2.5.2 Shenjat që u referohen/janë të lidhura me rreziqet për shëndetin publik

Ky grup përmban, pa kufizim, shenja ku elementët fjalë ose figurë ose kombinimi i tyre, përmbajnë dhe/ose janë të lidhur me veprime dhe/ose mosveprime që prekin dhe/ose rrezikojnë sigurinë dhe/ose shëndetin publik. Këtu përfshihen shenjat:

- që përkrahin dhe/ose banalizojnë një rrezik për sigurinë publike dhe/ose pasojat që vijnë prej tij; ose
- regjistrimi i të cilave përbën rrezik për sigurinë dhe/ose shëndetin publik.

Në parim, këto shenja kanë gjasë të konsiderohen në kundërshtim me **politikat publike** sa herë ato mund të kuptohen nga publiku përkatës se **nxitin dhe/ose banalizojnë qartësisht veprimet dhe/ose mosveprimet që prekin/rrezikojnë sigurinë dhe/ose shëndetin e publikut dhe/ose pasojat që vijnë prej këtyre veprimeve ose mosveprimeve**, të cilat janë vlera themelore për Shqipërinë dhe BE-në dhe mbrojtja e të cilave konsiderohet interes themelor sipas politikave shëndetësore të BE-së. Për më tepër, ato mund të konsiderohen në kundërshtim me **parimet e pranuar të moralit** sa herë ato **fyejnë dhe/ose tronditin qartazi vlerat dhe standardet morale të publikut përkatës** në çfarëdo mënyre.

⁽⁴⁵⁾ Sipas [fjalorit Collins](#), termi “hemp” është bimë e përdorur për të prodhuar litarë, por i referohet edhe kanabisit ose marihuanës.

E papranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
THE AMAZING BLUE WHALE CHALLENGE 	Klasa 41: Shërbime edukative dhe arsimore	Shenja i referohet sfidës në mediet sociale që shkaktoi viktima të shumta. Mesazhi i përçar nga shenja mund të kuptohet si nxitës i vetëlëndimit dhe vetëvrasjes, gjë që më së paku është kundër së drejtës themelore për jetën, sigurinë publike dhe mbrojtjen e shëndetit publik. Këto janë vlera themelore që mbulohen nga politikat e shëndetit në Shqipëri dhe BE, mbrojtja e të cilave është një prej interesave themelore të Shqipërisë dhe BE-së (sipas parashikimeve në KDThBE dhe në nenin 168, paragrafi 1, të TFBE-së). Prandaj, shenja konsiderohet në kundërshtim me politikat publike. Për më tepër, shenja është në kundërshtim edhe me parimet e pranuar të moralit sepse përdorimi për qëllime tregtare i nxitjes për vetëlëndim dhe vetëvrasje, i cili bie ndesh me të drejtën themelore për jetën, me gjasë do të trondiste dhe ofendonte publikun përkatës, në të cilin përfshihen grupmoshat e cënueshme.
THE BINGE DRINKING CHALLENGE TOUR – DRINK TILL YOU DROP	Klasa 39: Shërbime udhëtimesh	Mesazhi i përçar nga shenja nxit konsumin e një sasive të tepruar alkooli brenda një periudhe të shkurtër kohe, gjë që më së paku është kundër politikave të shëndetit në Shqipëri dhe BE dhe kundër interesave themelore të Shqipërisë dhe BE-së për të mbrojtur dhe përmirësuar shëndetin publik, sipas parashikimeve të nenit 168, paragrafi 1, të TFBE-së. Prandaj, shenja konsiderohet në kundërshtim me politikat publike. Për më tepër, shenja është në kundërshtim edhe me parimet e pranuar të moralit sepse banalizon konsumin e alkoolit në mënyrë të tillë që shkakton fyerje, pasi konsumi i tepruar i alkoolit shkakton dëme serioze në shëndet. Prandaj, ky inkurajim mund të perceptohet se bie ndesh me vlerat morale dhe standardet e shoqërisë në Shqipëri, në një Shtet Anëtar të veçantë, ose sipas rasti, në BE.

Për më tepër, shenja **ka më shumë gjasë** të konsiderohet në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së **kur përdorimi i saj përbën rrezik për sigurinë dhe/ose shëndetin publik**; për shembull, në rast se shenja i ngjan shumë një simboli të përdorur për të paralajmëruar një rrezik të veçantë për sigurinë dhe përdorimi i saj do të informonte dhe/ose paralajmëronte publikun në mënyrë të gabuar për ekzistencën e një rreziku ose në rast se shenja do të shkurajonte në mënyrë aktive respektimin e masave për shëndetin dhe sigurinë. Ky informacion i gabuar ose i rrezikshëm mund të perceptohet nga paraqitja e shenjës dhe/ose nga mallrat dhe/ose shërbimet për të cilat është bërë aplikimi.

E papranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
HELMETS ARE FOR LOSERS	Klasa 12: Motoçikleta	Mesazhi i përçar nga shenja në lidhje me mallrat për të cilat është bërë aplikimi sugjeron se njerëzit që përdorin helmata kur ngasin motoçikleta konsiderohen si "losers", kështu qasja e tyre e kujdesshme ndaj çështjeve të sigurisë shihet si shenjë frike dhe dobësie. Ky mesazh mund të perceptohet si inkurajim për të mos përdorur helmatat, të cilat janë të detyrueshme për sigurinë publike dhe mospërdorimi i tyre nënkupton

		vepër penale të sigurisë rrugore në Shqipëri dhe në shumë Shtete Anëtare të BE-së, në pajtim me politikat për mbrojtjen civile dhe të shëndetit që mbulohen nga normat themelore, sipas nenit 91, paragrafi 1, germa “c” dhe nenit 168, paragrafi 1, të TFBE-së. Prandaj, shenja është në kundërshtim me politikat publike.
	Klasa 9: Bateri me voltazh të ulët	Shenja është thuajse identike me simbolin ndërkombëtar të rrezikut ose të paralajmërimit i njohur si “simboli i voltazhit të lartë” ose “kujdes, ka rrezik për goditje elektrike”. Përdorimi i këtij simboli duhet të kufizohet në situata ku publiku duhet të ketë dijeni për rrezikun për voltazh të lartë. Përdorimi i tij në një markë tregtare, në një kontekst ku nuk ka rrezik real për voltazh të lartë, mund të ulë rëndësinë e këtij simboli rreziku në sytë e publikut dhe mund të përbëjë rrezik për sigurinë dhe/ose shëndetin publik sepse mund t'i orientojë konsumatorët të injorojnë simbolin në situata të rrezikshme ku ai është përdorur me vend. Kjo ulje e rëndësisë është edhe më domethënëse pasi mallrat për të cilat është bërë aplikimi funksionojnë me elektricitet. Kjo gjë bie ndesh me vlera themelore të sigurisë dhe shëndetit publik të Shqipërisë dhe BE-së sipas parashikimeve në KDThBE dhe në nenin 168, paragrafi 1, të TFBE-së. Prandaj, shenja konsiderohet në kundërshtim me politikat publike.

Gjithsesi, fakti që shenja i referohet një rreziku për sigurinë publike dhe/ose pasojave që vijnë prej tij, nuk nënkupton se ajo do të refuzohet menjëherë sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së. Në përgjithësi, ky tip shenjash **nuk** do të konsiderohet në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së **në rastet ku shenja synon të edukojë ose të rritë ndërgjegjësimin ose të kapërcehet rreziku dhe/ose pasojat që vijnë nga rreziku për sigurinë e publikut.**

2.5.3 Shenjat që kanë lidhje me fenë ose shenjtërinë

Ky grup përmban, pa kufizim, shenja ku elementët fjalë ose figurë ose kombinimi i tyre, përmbajnë dhe/ose janë të lidhura me elementët fetarë dhe të shenjtë të mëposhtëm:

- figura drejtuese (p.sh. Papa për Kishën Katolike),
- simbolet,
- tekstet,
- ceremonitë,
- adhuruesit.

Një shenjë që i referohet ose përmban figura, simbole dhe/ose ceremoni fetare/të shenjta shumë të respektuara nga besimtarët e asaj feje, ka të ngjarë të jetë **në kundërshtim me politikat publike dhe/ose parimet e pranura të moralit kur perceptohet si fyese, diskriminuese, zvetënuese, denigruese dhe/ose banalizuese, duke shkaktuar kështu fyerje për ata besimtarë, sepse do të ishte e papranueshme për ndjeshmërinë e publikut të përgjithshëm nëse do të vihej në dijeni për fyerjen e shkaktuar.** Ekziston një interes publik në të siguruarin që të respektohen dhe të mbrohen të gjitha besimet dhe ndjeshmëritë fetare të publikut.

Megjithatë, jo çdo shenjë që përmban elementë fjalë dhe/ose figurë me lidhje fetare ose të shenjtë do të shkelte parimet e pranura të moralit në shoqërinë shqiptare ose shoqërinë e një Shteti Anëtar të BE-së dhe/ose BE-

së. Në parim, shenjat ku përfshihet paraqitja e figurave, simboleve, teksteve, ceremonive dhe/ose adhuruesve të fesë/shenjtërisë (pa konotacion denigrues) **nuk kanë gjasë** të refuzohen në bazë të nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së në rast se **ato zbatohen në mallra dhe/ose shërbime, ku qëllimi, përmbajtja ose përdorimi i synuar i të cilave ka lidhje me veprimtaritë fetare.**

E pranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
	Klasa 41: Edukim fetar	<i>Shenja ka të bëjë me dy elementë figurë: në plan të parë përshkruhet Shiva, një zotë Hindu dhe në sfond një numër pemësh dekorative të palmës. Duke marrë në konsideratë që shërbimet për të cilat është bërë aplikimi janë për shërbime fetare, nuk ka të ngjarë që publiku përkatës të fyhet nga përdorimi i shenjes në një markë tregtare. Prandaj, shenja është e pranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së.</i>
	Klasa 45: Shërbime fetare	<i>Shenja përbëhet nga kryqi latin i ndërtuar me një disenjo zemrash me ngjyra. Kryqi latin është simbol i krishterimit dhe përdoret shumë shpesh në lidhje me fenë. Shërbimet për të cilat është bërë aplikimi, të cilat kanë të bëjnë me praktikimin e fesë, përforcojnë mesazhin, duke mos lënë dyshime se shenja është konceptuar për qëllime fetare dhe nuk do të trondiste ose prekte vlerat morale të besimtarëve, të besimtarëve të feve të tjera, madje edhe të atyre që nuk besojnë fare. Përveç kësaj, publiku përkatës do ta hasë shenjen në mjedise fetare. Prandaj, shenja është e pranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së.</i>

Në të kundërt, nëse një shenjë e përfshirë në këtë grup **zbatohet për mallra dhe/ose shërbime banale që nuk lidhen me veprimtari fetare**, ka më shumë të ngjarë që shenja të fyjë dhe/ose ofendojë vlerat morale të shoqërisë shqiptare ose të shoqërisë së një Shteti Anëtar të BE-së dhe/ose të BE-së. Përdorimi banal i një shenje që në thelb ka të bëjë me simbole fetare që respektohen thellë nga besimtarët e fesë në fjalë ka **më shumë të ngjarë të konsiderohet në kundërshtim me parimet e pranura të moralit.**

E papranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
	Klasa 16: Letër higjienike	<i>Kombinimi i kryqit latin, elementit fjalë “CRUCIFIX” dhe i mallrave për të cilat aplikohet shenja ka shumë të ngjarë të shihet si fyerje e pajustificuar ndaj vlerës morale të respektit për simbolet fetare që respektohen fort nga besimtarët dhe ndjeshmërisë së shoqërisë në Shqipëri, në një Shtet Anëtar të BE-së të veçantë, ose sipas rastit, në BE. Prandaj, jo vetëm të krishterët, por edhe besimtarët e besimeve të tjera ose edhe ata që nuk besojnë fare që mund ta hasin shenjen në një supermarket për shembull, do ta perceptonin atë si të papranueshme dhe të pasjellshme. Prandaj, shenja është në kundërshtim me parimet e pranura të moralit.</i>

 VIRGIN MARY's DELIGHTS	Klasa 10: Lodra seksi	<i>Edhe pse paraqitja e Shën Mërisë përdorur për "lodra seksi" do të gjendet në dyqane të specializuara, shenja do të perceptohet si tejet tronditëse dhe fyese pa arsye ndaj vlerave morale jo vetëm të të krishterëve, por edhe të besimtarëve të feve të tjera ose të jobesimtarëve, për shkak të përdorimit të një figure tejet të respektuar nga besimtarët në një lodër seksi. Prandaj, shenja është në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit.</i>
--	------------------------------	--

Në të kundërt, nëse një shenjë e përfshirë në këtë grup **zbatohet për mallra dhe/ose shërbime që nuk lidhen me veprimtari fetare, por nuk fyen dhe/ose shkel vlerat morale** të besimtarëve të asaj feje dhe të shoqërisë shqiptare ose të shoqërisë së një Shteti Anëtar të BE-së dhe/ose të BE-së, **nuk ka të ngjarë që të konsiderohet në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit**.

E pranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
Jewish delights	Klasa 30: Produkte ushqimore	<i>Shenja përbëhet nga elementët fjalë "JEWISH DELIGHTS" e përdorur për produkte ushqimore. Edhe pse shenja nuk përdoret për mallra ose shërbime fetare, ajo nuk transmeton mesazh fyese ose ofendues që do të shkelte vlerat morale të besimtarëve të asaj feje ose të shoqërisë shqiptare ose të shoqërisë së një Shteti Anëtar të BE-së të veçantë, ose sipas rastit, të shoqërisë së BE-së. Prandaj, shenja nuk është në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit.</i>
	Klasa 33: Verë	<i>Shenja përbëhet nga një paraqitje e pastër të Shën Gjergjit pa transmetuar mesazh fyese ose ofendues. Sa i takon mallrave ku është përdorur ajo, nuk është e pazakontë përdorimi i termave fetarë në sektorin e verërave, madje dhe emra shenjtorësh, të cilët zakonisht përkojnë me emrin e një qyteti apo qyteze ku është prodhuar vera. Prandaj, shenja nuk është në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit.</i>

Përveç kësaj, respektimi dhe liria e fesë nuk janë vetëm parime themelore të mishëruara në disa norma themelore të Shqipërisë, BE-së dhe një Shteti Anëtar të BE-së (p.sh. KDThBE-ja), por konsiderohen edhe si një prej themeleve të një shoqërie demokratike. Prandaj, nëse shenja ose mesazhi i përçarur prej saj mund të **perceptohet qartazi se mohon dhe/ose nxit, lavdëron, banalizon ose justifikon shkeljen e këtyre parimeve dhe prek një interes që Shqipëria, BE-ja dhe/ose Shtetet Anëtare të BE-së të prekura e konsiderojnë themelor në pajtim me sistemet e tyre të parimeve dhe vlerave, shenja edhe në këtë rast do të konsiderohej në kundërshtim me politikat publike**.

E papranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
	Klasa 25: Veshje	<i>Shenja përçon mesazh për mungesë respekti ose intolerancë të theksuar kundrejt besimeve dhe vlerave të krishtera, gjë që përsëri, më së paku, është në kundërshtim me të drejtën themelore shqiptare dhe të BE-së të sanksionuar në nenin 10 të KDThBE-së. Prandaj, shenja është në kundërshtim edhe me politikat publike dhe me parimet e pranuar të moralit.</i>

Në parim, shenjat që i referohen ose përmbajnë një figurë, simbol, tekst, ceremoni dhe/ose adhurues fetar/të shenjtë në mënyrë provokuese, ofenduese ose profane dhe/ose sulmojnë një fe në mënyrë të pajustificuar ose abuzive, kanë gjasë të jenë në kundërshtim me parimet e pranura të moralit, pasi ato mund të perceptohen se fyejnë dhe/ose shkelin vlerat morale të besimtarëve të fesë në fjalë dhe të shoqërisë shqiptare ose të shoqërisë së një Shteti Anëtar dhe/ose BE-së.

E papranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
 VIRGIN MARY'S BROTHEL	Klasa 35: Shitje veshjesh me pakicë	Kombinimi i një imazhi të Shën Mërisë me elementët fjalë "VIRGIN MARY'S BROTHEL", përdorur për shërbime të shitjes me pakicë të veshjeve, transmeton një mesazh provokues dhe fyes të pajustificuar kundrejt vlerave morale jo vetëm të të krishterëve, por edhe të besimtarëve të feve të tjera apo edhe të jobesimtarëve, të cilët mund ta hasin shenjën rastësisht në jetën e tyre të përditshme. Prandaj, shenja është në kundërshtim me parimet e pranura të moralit .
 VISHNU IDIOT	Klasa 18: Çanta	Kombinimi i një imazhi të Vishnu-së, zot Hindu, me elementët fjalë "VISHNU IDIOT", përdorur për çanta, transmeton një mesazh provokues dhe fyes të pajustificuar kundrejt vlerave morale jo vetëm të hinduve, por edhe të besimtarëve të feve të tjera apo edhe të jobesimtarëve, të cilët mund ta hasin shenjën rastësisht në jetën e tyre të përditshme. Prandaj, shenja është në kundërshtim me parimet e pranura të moralit .

Duhet marrë parasysh fakti se **legjislacioni i disa Shteteve Anëtare parashikon dispozita të posaçme për ruajtjen dhe mbrojtjen e shenjave me vlerë të lartë simbolike, në veçanti të simboleve fetare, nga regjistrimi në markat tregtare** ⁽⁴⁶⁾.

2.5.4 Shenjat që përmbajnë/lidhen me elementë vulgarë (sharje, gjeste fyese etj.)

Ky grup përmban, pa kufizim, shenja në të cilat elementët fjalë ose figurë ose kombinimi i tyre, përmban dhe/ose është e lidhur me:

- sharjet,
- gjestet ose sjelljet fyese,
- ofendimet.

Neni 4, paragrafi 1, germa "f" i DMT-së, ndër të tjera, ka të bëjë me mbrojtjen e primeve dhe vlerave të sistemit juridik shqiptar dhe nuk përmban ndonjë grup me rregulla gjuhësore për eliminimin e shprehjeve të pakëndshme ose të fjalorit të padëshirueshëm. Këto shenja duhet të kenë të paktën një **element të qartë vulgar dhe të jenë fyese. Sharjet, gjestet ose sjelljet fyese, fyerjet si dhe perceptimi publik për to mund të ndryshojë shumë në varësi të gjuhës së folur dhe pjesës të territorit** (p.sh. gjesti i dorës nën mjekër mund të perceptohet si fyes në Itali, por jo në Spanjë).

Në parim, këto shenja kanë gjasë të jenë **në kundërshtim me parimet e pranura të moralit** çdo herë që ato mund të perceptohen nga publiku përkatës se janë qartazi **fyese, përçmuese dhe/ose ofenduese për vlerat e tyre morale**, sidomos nëse shenja dhe/ose mesazhi i përçarur prej saj i drejtohen një grupi ose individi specifik.

⁽⁴⁶⁾ Sipas nenit 4, paragrafi 3, germa "b" të DMT-së.

Përveç kësaj, shenjat si këto mund të kenë karakteristika që do t'u kundërviheshin dhe/ose nxitnin kundërvënien ndaj normave, parimeve dhe/ose vlerave themelore në Shqipëri, BE dhe/ose në një Shtet Anëtar të BE-së dhe, për rrjedhojë, ato gjithashtu mund të konsiderohen në kundërshtim me politikat publike.

E papranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
	Klasa 25: Veshje	Shenja përbëhet nga elementët fjalë "FUCKING ASSHOLE", e cila është mënyrë fyese për t'iu referuar një personi dhe është tejet ofenduese dhe urryese, bashkë me elementin figurë të një dore me gishtin e mesit ngritur, gjë që është shfaqja grafike e një gjesti fyese. Publiku përkatës me nivel normal ndjeshmërie dhe tolerance do ta perceptojë në tërësi shenjen aq të fortë, tronditëse, fyese dhe ofenduese sa shenja është në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit për të gjitha mallrat dhe shërbimet .
	Klasa 18: Çanta	Shenja paraqet një person që përdor flamurin e BE-së si letër higjienike. Ky përdorim i flamurit mund të perceptohet si vulgar, fyese dhe ofendues nga publiku i përgjithshëm. Prandaj, shenja është në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit . Përveç kësaj, mesazhi i përçarë nga shenja mund të kuptohet si çshenjtërim i flamurit të BE-së dhe, si e tillë, nuk respekton të tërë rajonin, gjë që shkon kundër vlerave të përbashkëta të BE-së si respektimi i larmisë së kulturave dhe traditave të njerëzve në Evropë, siç e parashikon KDTBE-ja. Prandaj shenja është në kundërshtim edhe me politikat publike .

Megjithatë, është e mundur që, pavarësisht se përmban fjalë, gjeste dhe/ose sjellje të pakëndshme ose të padëshirueshme, shenja dhe/ose mesazhi i përçarë prej saj të mos konsiderohen aq fyese sa të refuzohen në bazë të parimeve të pranuar të moralit.

E pranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
	Klasa 33: Pije alkoolike	Sipas fjalorit "Collins", elementi fjalë "BASTARD" i referohet personit të lindur në momentin kur prindërit e tij kanë qenë të pamartuar, ndaj mund të jetë e pakëndshme të quhet me këtë term. Megjithatë, fakti që termi paraprihet nga fjalët "I AM A" do ta zbuste seriozitetin e fyerjes dhe do të sillte një element ironie dhe humori që i drejtohet vetvetes. Në lidhje me "pijen alkoolike" në Klasën 33, shenja nuk do të perceptohet si mesazh drejtuar një personi të tretë. Prandaj, shenja nuk është në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit .

Pavarësisht se disa sharje dhe gjeste fyese përdoren në fjalorin e përditshëm, ato përsëri mund të perceptohen si fyese nga pjesë të publikut. Në këtë aspekt, ekziston një interes publik në të siguruarin që të mos regjistrohen shenja që përmbajnë fjalë fyese me të cilat mund të përballen më pas konsumatorët, sidomos fëmijët dhe të rinjtë.

2.5.5 Shenjat që përmbajnë/lidhen me paturpësinë, seksualitetin dhe insinuatat

Ky grup përbëhet, pa u kufizuar, nga shenjat ku elementët fjalë ose figurë ose kombinimi i tyre kanë përmbajtje të fortë seksuale në lidhje me publikun që do ta haste shenjën duke konsideruar mallrat dhe shërbimet. Grupi përbëhet nga shenja që përmbajnë dhe/ose janë të lidhura me:

- aktivitetin/praktikat seksuale (masturbimi, akti i marrëdhënies seksuale etj.),
- organet gjenitale,
- lakuriqësinë,
- fjalët e zhargonit që u referohen pikave më lart.

Në parim, këto shenja kanë gjasë të jenë **në kundërshtim me parimet e pranuarra të moralit** çdo herë që ato mund të perceptohen nga publiku përkatës se janë qartazi **fyese, ofenduese dhe/ose tronditëse për vlerat e tyre morale për shkak të kuptimit të shenjës dhe, në fund të fundit, për shkak të mallrave dhe/ose shërbimeve ku ato aplikohen.**

E papranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa "F" të DMT-së		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
DON'T BE A C*NT	Klasa 25: Veshje	<i>Elementi fjalë "C*NT" në shenjë do të perceptohej qartazi nga publiku përkatës si fjala "cunt". Sipas fjalorit "Oxford", kjo është fjalë në zhargon për vaginën dhe organet e jashtme seksuale të një gruaje. Sa i takon klasës "veshje", publiku përkatës nuk do të jetë vetëm publiku i synuar, por edhe njerëz të tjerë që mund ta hasin shenjën rastësisht. Duke qenë se kjo fjalë do të shihej qartësisht ofenduese dhe fyese për vlerat morale të publikut përkatës, shenja është në kundërshtim me parimet e pranuarra të moralit.</i>
COCK	Klasa 18: Çanta	<i>Sipas fjalorit "Oxford", elementi fjalë "COCK" ka kuptime të ndryshme: mund të përdoret, ndër të tjera, për t'u referuar një "pule mashkull të rritur" (p.sh. këndes) dhe "penisit". Shenja nuk përmban asnjë element tjetër që të mund të ndikojë që shenja të kuptohet se i referohet "këndesit". Sa i takon klasës "çanta", publiku përkatës nuk do të jetë vetëm publiku i synuar, por edhe njerëz të tjerë që mund ta hasin shenjën rastësisht, për shembull në një dyqan ose në ecje e sipër. Prandaj, shenja është në kundërshtim me parimet e pranuarra të moralit pasi do të perceptohet si imorale, tronditëse dhe fyese në një prej kuptimeve të saj.</i>

Duhet nënvizuar se ka **industri të specializuara dhe/ose të lidhura vetëm me veprimtaritë të cilave u referohen këto shenja** (p.sh. industria e pornografisë, dyqanet e seksit/faqet e internetit që u kushtohen produkteve të seksit). Prandaj, **mallrat dhe/ose shërbimet ku ato përdoren luajnë rol të rëndësishëm në vlerësimi e shenjave të këtij grupi.**

Në parim, kur këto shenja përdoren në **mallra dhe/ose shërbime të lidhura me këto industri**, karakteri fyës do të zbutet, kështu shenja ka **më pak gjasë të konsiderohet në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, germa "F" të DMT-së** sepse ata që do të ekspozoheshin ndaj tyre kanë më pak gjasë të ofendohen dhe/ose tronditen nga përmbajtja e shenjës sesa publiku i gjerë.

E pranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
	Klasa 10: Lodra seksi	Pavarësisht faktit se fjalia "FLY ME TO THE MOON", në kombinim me elementin figurë, ka konotacion seksual, gjë që mund të perceptohej si e paturpshme, tronditëse dhe/ose fyese, shenja nuk konsiderohet ofenduese sepse mallrat për të cilat përdoret ajo ("lodra seksi") normalisht i ofrohen publikut në dyqane të specializuara. Kështu, konsumatorët përkatës nuk kanë gjasë të ofendohen ose tronditen nga një markë tregtare që përmban elementë fjalë dhe/ose figurë me ngarkesë seksuale. Përkundrazi, ata do ta shohin shenjen si aluduese në një mënyrë që shkakton humor. Prandaj, shenja është e pranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së.

Në të kundërt, kur këto shenja përdoren për mallra dhe/ose shërbime që nuk lidhen me këto industri, ato kanë më shumë gjasë të konsiderohen në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së sepse publiku i përgjithshëm do të ekspozohet ndaj një marke tregtare dhe me gjasë do të tronditej dhe/ose ofendohej nga përmbajtja e shenjes.

E papranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
	Klasa 28: Lodra për fëmijë	Fjalia "FLY ME TO THE MOON", në kombinim me elementin figurë, ka konotacion seksual gjë që mund të perceptohej si e paturpshme, tronditëse dhe fyese nga publiku i përgjithshëm. Duke qenë se mallrat për të cilat përdoret shenja i drejtohen një grupi të cënueshëm (në këtë rast fëmijëve), shenja konsiderohet në kundërshtim me parimet e pranura të moralit, sepse vënia në rrezik e mirëqenies së fëmijëve është imorale.

Është gjithashtu e mundur që shenja që përmban/lidhet me paturpësinë, seksualitetin dhe insinuatat nuk do të konsiderohej në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së, nëse shenja përmban vetëm një insinuatë të butë seksuale ose konsiderohet thjesht me humor dhe/ose aluduese dhe, si e tillë, ka shije të keqe. Po kështu, kur shenja, edhe pse e paturpshme, nuk transmeton asnjë mesazh, fyerje ose nxitje që do të konsiderohej në gjendje t'i shkaktonte fyerje të dukshme publikut të përgjithshëm dhe/ose nuk prek ose sulmon një grup të caktuar personash, do të kishte më pak gjasë që të konsiderohej në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së.

E pranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “F” të DMT-së		
Shenja	Mallra dhe shërbime	Arsyetimi
	Klasa 20: Mobilitet për tualetin	<i>Elementi figurë i shenjës, edhe pse është vulgar, përshkruan një funksion të natyrshëm të trupit me humor dhe në mënyrë joseksuale, prandaj shenja nuk ka gjasë të shkaktojë fyerje. Shumë shumë, shenja mund të duket e pakëndshme dhe me shije të keqe, por kjo nuk mjafton për ta konsideruar në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit.</i>
	Klasa 25: Veshje	<i>Shenja në pamje të parë do të perceptohej si paraqitje shumë e stilizuar e gremës “K”. Duke qenë se publiku i synuar i veshjeve tregon nivel mesatar vëmendjeje, ky publik do të ketë pak gjasë të angazhohet në një përpjekje të mëtejshme për ta interpretuar dhe inspektuar nga afër shenjën. Prandaj, perceptimi i paraqitjes së një pozicioni seksual nuk do të jetë i dukshëm menjëherë. Përveç kësaj, fëmijët e ekspozuar ndaj kësaj shenje kanë edhe më pak gjasë ta perceptojnë si përmbajtje seksuale. Prandaj, shenja nuk do të ishte në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit.</i>

2.5.6 Shenja që denigrojnë ose shpifin për një grup të veçantë

Në këtë grup përfshihen, dhe jo vetëm, shenja ku elementet fjalë dhe figurë ose kombinimi i tyre sulmojnë dhe/ose ulin një grup të veçantë për shkak të seksit dhe gjinisë, racës, ngjyrës, origjinës etnike ose shoqërore, anëtarësisë në një pakicë kombëtare, situatës së pasurisë, kushteve në lindje, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual etj. Në veçanti, këtu i referohemi shenjave që përbëhen ose përmbajnë:

- stereotipa fytes; dhe
- terma ose mesazhe që nxitin urrejtjen, paragjykimet, neverinë ose përjashtimin kundrejt një grupi ⁽⁴⁷⁾.

Shenjat që denigrojnë ose shpifin për një grup të veçantë kanë më shumë **gjasë** të konsiderohen se bien **ndesh vetëm me parimet e pranuar të moralit**, ndërkohë që shenja dhe/ose mesazhi i përcjellë prej saj mund të perceptohen nga publiku përkatës **si fytes, zvetënues dhe/ose përçmues për një grup të veçantë njerëzish**. Për më tepër, nëse shenja ose mesazhi që ajo përçon kuptohen **si diskriminues, racist, nxitje ose thirrje për urrejtje dhe/ose bie ndesh me një parim dhe ose një vlerë themelore në Shqipëri, në BE dhe/ose në një Shtet Anëtar të BE-së** (p.sh. respekti për të drejtat e njeriut, ku përfshihen të drejtat e personave që u përkasin pakicave), **me gjasë** shenja do të konsiderohet **edhe në kundërshtim me politikat publike**.

⁽⁴⁷⁾ Shih si referencë për qëllime informacioni: [Monitorimi i shenjave dhe simboleve diskriminuese në futbollin evropian] Monitoring discriminatory signs and symbols in European football (Fare Network): https://www.farenet.org/wp-content/uploads/2016/10/Signs-and-Symbols-guide-for-European-football_2016-2.pdf

E papranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “” të DMT-së

Shenja	Mallrat dhe shërbimet	Arsyetimi
	Klasa 41: Shërbime edukative dhe arsimore	Shenja përfshin një element figurë që është simbol i kolektivit LGBTIQ+, i cili shoqërohet me elementët fjalë “LET’S KEEP THEM STRAIGHT”. Duke marrë në konsideratë se fjala “straight” është term në zhargon që i referohet personave heteroseksualë, shenja mund të perceptohet se përçon një mesazh diskriminimi, homofobie, përbuzjeje, paragjykimi, neverie, urrejtjeje dhe/ose përjashtimi kundrejt një grupi të veçantë, gjë që më së paku është në kundërshtim me parimet dhe vlerat themelore të Shqipërisë, të cilat janë të përbashkëta për të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së, si dinjiteti i njeriut, gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi, ashtu siç janë përcaktuar në KDThBE. Prandaj, shenja është në kundërshtim edhe me politikat publike edhe me parimet e pranura të moralit për të gjitha mallrat dhe shërbimet.
	Klasa 43: Shërbime të shtëpive për të moshuarit	Shenja përçon një mesazh që mund të perceptohet si denigrues, diskriminues për shkak të moshës dhe fyes për të moshuarit, gjë që më së paku është në kundërshtim me parimet dhe vlerat themelore të Shqipërisë dhe që janë të përbashkëta për të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së si dinjiteti i njeriut, gjithëpërfshirja dhe mosdiskriminimi, ashtu siç janë përcaktuar në KDThBE. Prandaj, shenja është në kundërshtim edhe me politikat publike edhe me parimet e pranura të moralit.
	Klasa 41: Shërbime edukative dhe arsimore	Mesazhi i përçar nga shenja në kontekstin e shërbimeve për të cilat zbatohet ajo është se puna në kuzhinë duhet të jetë i vetmi synim i jetës për gratë. Ky mesazh perceptohet si zvetënues për gratë në përgjithësi. Prandaj, shenja është në kundërshtim me parimet e pranura të moralit. Përveç kësaj, mesazhi i përçar nga shenja bie ndesh me parimet dhe vlerat themelore të Shqipërisë, të cilat janë të përbashkëta për të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së si mosdiskriminimi, gjithëpërfshirja, drejtësia, solidaritetit etj., sidomos barazia midis burrave dhe grave, siç janë përcaktuar në KDThBE. Prandaj, shenja konsiderohet edhe në kundërshtim me politikat publike.
	Klasa 30: Çokollatat	Shenja paraqet një rresht personash me ngjyrë në një plantacion kakaoje duke ndjekur nga pas një kolonizator. Elementët figurë përçojnë një pikëpamje të epërsisë së të bardhëve që mund të ndihmojë përjetësimin e stereotipave negativë të inferioritetit dhe varësisë së personave me ngjyrë të zezë. Ky kombinim ka gjasë të tronditë, bezdisë dhe fyejë jo vetëm vlerat morale të grupit që denigrohet, por edhe të gjithkujt tjetër që përballet me shenjën dhe ka nivele normale ndjeshmërie dhe tolerance. Për më tepër, mbajtja jashtë regjistrave e mesazheve për dallimet racore është çështje e politikave publike sepse këto mesazhe përforcojnë paragjykimet. Nga publiku i gjerë shenja do të perceptohet se përçon, si minimum, mesazh

		diskriminimi, racizmi dhe paragjykimi kundrejt një grupi të veçantë, gjë që bie në kundërshtim me parimet dhe vlerat themelore të Shqipërisë, të cilat janë të përbashkëta për të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së si mosdiskriminimi, gjithëpërfshirja, drejtësia, barazia dhe solidariteti, siç janë përcaktuar në KDThBE. Prandaj, shenja është në kundërshtim edhe me politikat publike edhe me parimet e pranura të moralit për të gjitha mallrat dhe shërbimet.
	Klasa 25: Veshje	Mesazhi “WHITE LIVES MATTER” është parullë e aktivistëve të epërsisë së të bardhëve nëpër botë, e cila lindi në vitin 2015 si përgjigje raciste ndaj lëvizjes “Black Lives Matter” ⁽⁴⁸⁾. Në kombinim me sfondin që përbëhet nga flamuri i Shteteve të Konfederatës së Amerikës ⁽⁴⁹⁾, shenja mund të perceptohet nga publiku i gjerë si fyese dhe denigruese për komunitetin me ngjyrë dhe për personat e angazhuar në luftën për të drejtat civile dhe se shfrytëzon tragjedinë e mirënjohur për shkak të së cilës lindi lëvizja “Black Lives Matter”. Prandaj, shenja është në kundërshtim me parimet e pranura të moralit. Mesazhi i përforcuar nga flamuri i Konfederatës është diskriminues dhe racist. Përveç kësaj, kjo mund të konsiderohet nxitje ose thirrje për urrejtje, gjë që bie në kundërshtim me parimet dhe vlerat themelore të Shqipërisë, të cilat janë të përbashkëta edhe për të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së si mosdiskriminimi, gjithëpërfshirja, drejtësia, barazia dhe solidariteti, siç janë përcaktuar në KDThBE. Prandaj, shenja është në kundërshtim edhe me politikat publike.
 SLAY THE PIGS!	Klasa 25: Uniformat	Shenja përbëhet nga një element figurë që përfaqëson dy derra që mbajnë një soj kapeleje policie si dhe fjalët “SLAY THE PIGS!”. Lidhja që shenja vendos ndërmjet kafshës dhe policisë përforcon kuptimin e termiit “pigs” në zhargon, i përdorur për t’iu referuar policisë. Mesazhi i përçarë nga shenja mund të shihet nga publiku i gjerë jo vetëm si nxitës i dhunës kundër policisë, por edhe si denigrues dhe poshtërues jo vetëm kundrejt atyre që punojnë në fushën e forcave të sigurisë dhe agjencive ligjzbatuese, por edhe kundrejt publikut të gjerë që ka besim në punën e tyre, të cilat janë të nevojshme për të garantuar parimet dhe vlerat themelore të Shqipërisë dhe që janë të përbashkëta për të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së si shteti i së drejtës, liria, demokracia, të drejtat e njeriut etj. Prandaj, shenja është në kundërshtim me parimet e pranura të moralit. Përveç kësaj, duke pasur parasysh se shenja nxit

⁽⁴⁸⁾ Lëvizja “Black Lives Matter” është lëvizje shoqërore ndërkombëtare, e cila u formua në Shtetet e Bashkuara në vitin 2013. Ajo i kushtohet luftës kundër racizmit dhe dhunës ndaj personave me ngjyrë, sidomos në formën e brutalitetit të policisë. Emri “Black Lives Matter” sinjalizon dënimin e vrasjes së padrejtë të personave me ngjyrë nga policia dhe kërkon që shoqëria të çmojë jetët dhe natyrën njerëzore të personave me ngjyrë, njësoj siç çmon jetët dhe natyrën njerëzore të të bardhëve.

⁽⁴⁹⁾ Në vitet 1860 dhe 1861, njëmbëdhjetë shtete të jugut u shkëputën nga Shtetet e Bashkuara për të mbrojtur institucionin e skllavërisë dhe formuan Shtetet e Konfederatës së Amerikës, duke ndezur kështu luftën civile në Shtetet e Bashkuara. Pas luftës, flamuri i tyre u përdor si simbol i trashëgimisë së jugut, teksa përfaqësonte në të njëjtën kohë skllavërinë dhe epërsinë e të bardhëve.

		dhunën, është përçmuese dhe tregon mungesë respekti ndaj një organizate publike, mund të konsiderohet se është në kundërshtim me parimet dhe vlerat themelore të Shqipërisë, të cilat janë të përbashkëta për të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së, më së paku, si shteti i së drejtës, siç janë përcaktuar në KDThBE, prandaj është në kundërshtim me politikën publike.
	Klasa 36: Shërbimet financiare	Ky element figurë i referohet hebrenjve dhe njihet e perceptohet nga ky komunitet si stereotip fyes, sharës dhe denigrues. Prandaj, shenja është në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit. Përveç kësaj, shenja mund të perceptohet si sharje antisemite, e cila bie ndesh me parimet dhe vlerat e Shqipërisë dhe BE-së, si për shembull ato të barazisë midis të gjitha qenieve njerëzore, ashtu siç përcaktohen në KDThBE. Prandaj, shenja konsiderohet në kundërshtim me politikën publike.

E pranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së		
Shenja	Mallrat dhe shërbimet	Arsyetimi
	Klasa 18: Çantat	Edhe pse shenja i referohet një grupi të veçantë njerëzish, konkretisht njerëzve me ngjyrë, me gjasë publiku i gjerë, sidomos grupi i synuar, nuk e percepton si fyes ose përçmues kundrejt grupit të veçantë të cilit i referohet. Prandaj, shenja nuk është në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, ferma "f" të DMT-së.

2.5.7 Shenja që i referohen/lidhen me veprimtari kriminale; krime kundër njerëzimit; regjime, organizata dhe lëvizje raciste, totalitare dhe ekstremiste

Ky grup përfshin, pa kufizim, shenjat ku elementët fjalë ose figurë, ose kombinimi i tyre, i referohen dhe/ose lidhen me aktet e mëposhtme si dhe me viktimat e tyre:

- veprimtaritë e paligjshme (krimet);
- krimet e luftës, me të cilat nënkuptojmë, ndër të tjera, shkeljet e rënda të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura ndërkombëtare ⁽⁵⁰⁾ (p.sh. trajtimi çnjerëzor, marrja e pengjeve, sulmi apo bombardimi, pa marrë parasysh me çfarë mjetesh, i qyteteve, fshatrave, banesave apo ndërtesave të pambrojtura e që nuk janë objektiva ushtarake);
- krimet kundër njerëzimit, me të cilat nënkuptojmë aktet e kryera si pjesë e sulmit të gjerë apo sistematik të drejtuar kundër cilësdo popullate civile, me paramendim ⁽⁵¹⁾ (p.sh. vrasje, terrorizëm ⁽⁵²⁾, shfarosje, skllavërim, torturë, skllavërim seksual, zhdukje e detyrueshme e personave, krime të aparteidit dhe akte të tjera çnjerëzore me karakter të ngjashëm të cilat shkaktojnë qëllimisht vuajtje ose lëndime serioze në trup ose në shëndetin fizik ose mendor); ose
- regjimet, organizatat dhe lëvizjet totalitare dhe ekstremiste (p.sh. lëvizjet për epërsinë e të bardhëve, Ku Kluks Klan, lëvizjet e bazuara në ideologjinë naziste etj.).

⁽⁵⁰⁾ Neni 8 i Statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale.

⁽⁵¹⁾ Neni 7 i Statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale.

⁽⁵²⁾ [Direktiva \(BE\) 2017/541 për luftën kundër terrorizmit](#); Qëndrimi i Përbashkët 2001/931/PPJS për zbatimin e masave specifike për të luftuar terrorizmin (Gazeta Zyrtare L 344, 28.12.2001, f. 93), miratuar më vonë si Vendim i Këshillit (PPJS) 2017/1426 datë 04.08.2017, ku përditësohet lista e personave, grupeve dhe entiteteve të përfshira në akte terroriste të cilët janë subjekt i masave shtrënguese: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32017D1426&from=EN>.

Në parim, këto shenja kanë gjasë të konsiderohen edhe kundër politikave publike edhe kundër parimeve të pranura të moralit.

Ato kanë të ngjarë të konsiderohen në kundërshtim me politikat publike sa herë ato u referohen dhe/ose janë të lidhura me akte që bien ndesh me normat, parimet dhe vlerat themelore në të cilat mbështeten Shqipëria, një Shtet Anëtar i BE-së dhe/ose BE-ja, sidomos kur bien ndesh me dinjitetin njerëzor, lirinë, integritetin fizik, barazinë dhe solidaritetin, respektin për personat që u përkasin pakicave, parimin e demokracisë dhe me shtetin e së drejtës, sipas parashikimeve të nenit 2 të Traktatit për Bashkimin Evropian dhe nenet 2, 3 dhe 6 të KDThBE-së, ose kur ato nxitin, lavdërojnë, banalizojnë ose justifikojnë këto shkelje. Këto vlera janë të pandashme dhe përbëjnë pasuritë shpirtërore dhe morale të Shqipërisë dhe të gjithë Bashkimit Evropian.

Për më tepër, krimi i organizuar dhe veprimtaritë e tjera të renditura më lart janë disa prej fushave me krime veçanërisht të rënda me përmasë ndërkufitare në të cilat legjislatura e BE-së mund të ndërhyjë, sipas parashikimeve të nenit 83 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) ⁽⁵³⁾.

Këto shenja ka të ngjarë të konsiderohen në kundërshtim me parimet e pranura të moralit sa herë ato perceptohen se banalizojnë këto akte dhe/ose transmetojnë në mënyrë të dukshme një mesazh fyes kundrejt vlerave dhe standardeve morale të Shqipërisë, të shoqërisë së një Shteti Anëtar të BE-së dhe/ose të BE-së.

Që shenja e përfshirë në këtë grup të refuzohet në bazë të nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së, duhet që në mendjen e publikut të krijohet një bashkëshoqërim midis kuptimit të shenjës dhe veprimtarisë/organizatës kriminale së cilës ajo i referohet. Mund të ketë raste në të cilat kuptimi i shenjës dhe/ose mesazhi i përçar nga ajo është kaq i fortë, sa ajo mund të refuzohet pavarësisht mallrave dhe/ose shërbimeve për të cilat zbatohet.

E papranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së		
Shenja	Mallrat dhe shërbimet	Arsyetimi
	Klasa 45: Shërbimet e sigurisë	Elementi figurë në shenjë përfaqëson qartazi një anëtar të grupit terrorist të urrejtjes dhe epërsisë së të bardhëve Ku Kluks Klan (KKK), për shkak të tunikës së bardhë me kapuç me emblemën e këtij grupi mbi të. Përveç kësaj, personi ka ngritur lart krahun e djathtë në mënyrë të tillë që ngjan me përshëndetjen naziste. Publiku përkatës do ta perceptojë mesazhin e përçar nga shenja kaq të fortë dhe kaq thellësisht të lidhur me veprimet raciste dhe kriminale, sa në asnjë mënyrë nuk mund të vlerësohet si mesazh me nuanca. Ky mesazh është në kundërshtim me vlerat universale dhe të pandashme mbi të cilat është [janë] ndërtuar Shqipëria dhe BE-ja, konkretisht dinjiteti njerëzor, liria, integriteti fizik, barazia dhe solidariteti dhe parimet e demokracisë dhe shtetit të së drejtës siç janë shpallur në KDThBE. Prandaj, shenja është në kundërshtim me politikat publike edhe nëse grupi të cilit i referohet ose viktimat e tij nuk janë në Shqipëri ose në BE. Gjithashtu, ky demonstrim mund të perceptohet si tronditës dhe fyes nga publiku përkatës, prandaj shenja është në kundërshtim edhe me parimet e pranura të moralit. Shenja është e papranueshme për të gjitha mallrat dhe shërbimet.

⁽⁵³⁾ 15.03.2018, T-1/17, La Mafia se sienta a la mesa (fig.), EU:T:2018:146, § 36.

	Klasa 25: Veshjet	Germat “SS” dhe elementët fjalë “RISES AGAIN!”, së bashku me elementin figurë të një kafke, qartësisht i referohen “Schutzstaffel” ose Skuadrave të Mbrojtjes, një organizatë e madhe ushtarake nën drejtimin e Adolf Hitlerit dhe partisë naziste në Gjermani, e cila u deklarua organizatë kriminale për shkak të përfshirjes së saj të drejtpërdrejtë në kryerjen e mizorive të luftës. Publiku përkatës do ta perceptojë mesazhin e përçar nga shenja kaq të fortë dhe kaq thellësisht të lidhur me nazizmin dhe veprimet kriminale, sa në asnjë mënyrë nuk mund të vlerësohet si mesazh me nuanca. Ky mesazh është në kundërshtim me vlerat universale dhe të pandashme mbi të cilat është [janë] ndërtuar Shqipëria dhe BE-ja, konkretisht dinjteti njerëzor, liria, integriteti fizik, barazia dhe solidariteti dhe parimet e demokracisë dhe shtetit të së drejtës siç janë shpallur në KDTHE. Prandaj, shenja është në kundërshtim me politikën publike. Gjithashtu, ky demonstrim mund të perceptohet si tronditës dhe fyes nga publiku përkatës, prandaj shenja është në kundërshtim edhe me parimet e pranuar të moralit. Shenja është e papranueshme për të gjitha mallrat dhe shërbimet.
---	--------------------------	---

2.5.8 Shenja që u referohen ngjarjeve tragjike të njohura

Ky grup përfshin, pa kufizim, shenja ku elementët fjalë ose figurë, ose kombinimi i tyre, përmbajnë dhe/ose lidhen me:

- ngjarje tragjike,
- viktimat që shkaktoi ngjarja tragjike,
- pasojat që erdhën si rezultat i ngjarjes tragjike.


Kur vlerësohet një shenjë që i referohet ose lidhet me një ngjarje tragjike të njohur, ndër të tjera, duhet të konsiderohen faktorët e mëposhtëm në mënyrë që të përcaktohet nëse shenja duhet të mos pranohet në bazë të nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së:

- natyra e ngjarjes;
- konteksti historik dhe kombëtar i një situate të dhënë;
- ndjeshmëria ose perceptimi i publikut (p.sh. nëse pjesë e publikut përkatës e percepton shenjen si ofenduese dhe me mungesë respekti, edhe kur nuk ka asociim me viktimat);
- pasoja ose ndikimi në një komunitet (sa thellë është prekur publiku vendas nga tragjedia – duhet të vihet në dukje se ngjarjet tragjike mund të kenë ndikim te njerëzit për breza të tërë, edhe nëse nuk ka të mbijetuar ose persona të gjallë që janë prekur drejtpërdrejt nga tragjedia);
- distanca kohore ndërmjet ngjarjes tragjike dhe shqyrtimit të dosjes; për shembull, nëse ka kaluar shumë kohë, ka mundësi që publiku përkatës të mos e lidhë shenjen me tragjedinë, ose edhe nëse e lidh, publiku nuk ndihet i fyer (p.sh. pushtimi romak i një vendi dy mijë vjet më parë nuk ka të ngjarë të jetë fyes për askënd, ndërsa ngjarjet që janë më afër në kohë si Lufta e Dytë Botërore ose aparteidi kanë shumë më tepër gjasë të jenë ende fyes); dhe
- nëse fjala e lidhur me tragjedinë ka marrë një kuptim dytësor (si “Titaniku”, për shkak të filmit).

Në rast se, pasi janë marrë në konsideratë faktorët e mësipërm, mund të dilet në përfundimin se shenja që përmban ose lidhet me një ngjarje tragjike të njohur mund të perceptohet se përçon **një mesazh të qartë fyes, i cili banalizoj natyrën e ngjarjes tragjike, përfiton nga ngjarja tronditëse për të tërhequr konsumatorët**

ose ka të ngjarë të ofendojë, përçmojë, poshtërojë dhe/ose fyejë viktimat dhe publikun e gjerë, shenja ka gjasë të konsiderohet në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit.

Kjo lloj shenje mundet të konsiderohet edhe në kundërshtim me politikat publike nëse shenja dhe/ose mesazhi i përçarë prej saj bie ndesh me normat dhe parimet themelore të Shqipërisë, të një Shteti Anëtar të BE-së dhe/ose të BE-së (p.sh. dinjiteti njerëzor), lavdëron, banalizon dhe/ose justifikon këtë shkelje, ose nëse prek një interes themelor të Shqipërisë, të një Shteti Anëtar të BE-së dhe/ose të Bashkimit Evropian si një i tërë.


E papranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa "f" të DMT-së		
Shenja	Mallrat dhe shërbimet	Arsyetimi
	Klasa 41: Organizimi i shërbimeve të dëfrimit	Shenja i referohet qartazi tërmetit tragjik, cunamit dhe katastrofës bërthamore që ndodhi në Fukushima, Japoni në vitin 2011. Kombinimi i mesazhit "FUKUSHIMA, YOU'RE GOING TO DROWN IN FUN" me elementët figurë perceptohet se banalizon tragjedinë dhe viktimat e saj dhe ka të ngjarë të ofendojë viktimat ose të afërmit e tyre. Përveç kësaj, fakti se aplikimi është bërë për shenjën e lidhur me "organizimin e shërbimeve të dëfrimit" tregon se aplikuesi përpiqet të nxjerrë përfitime tregtare nga kjo ngjarje tronditëse për të tërhequr konsumatorët, duke theksuar karakterin fyes të shenjës. Prandaj, shenja është në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit.
AUSCHWITZ COCKTAIL	Klasa 33: Pije alkoolike	"Auschwitz" ishte një kamp përqendrimi nazist i ndodhur në Poloninë e pushtuar nga Gjermania gjatë Luftës së Dytë Botërore. Prandaj, referenca ndaj "AUSCHWITZ COCKTAIL" në kontekstin e pijeve alkoolike perceptohet se banalizon tragjedinë dhe viktimat e saj. Duke mbajtur parasysh se kategoria "pije alkoolike" është kategori e gjerë dhe popullore produktesh që lidhen kryesisht me dëfrimin, mund të dilet në përfundimin se aplikuesi duket se dëshiron të tërheqë konsumatorët duke përfituar nga kjo ngjarje tronditëse, gjë që është në kundërshtim me vlerat themelore ku mbështeten Shqipëria dhe BE-ja, konkretisht dinjiteti njerëzor, liria, barazia dhe solidariteti, parimet e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, ashtu siç janë shpallur në KDThBE. Në këto rrethana, shenja do të perceptohet si fyese jo vetëm në lidhje me viktimat, por edhe në lidhje me çdo person me nivele normale ndjeshmërie dhe tolerance. Prandaj shenja është në kundërshtim me politikat publike dhe parimet e pranuar të moralit.
	Klasa 37: Shërbime pastrimi	Shenja i referohet qartazi sulmit tragjik terrorist që ndodhi në Bataclan në Paris, në vitin 2015. Sepse "shërbime pastrimi" do të perceptohet se banalizon tragjedinë dhe përfiton nga ngjarja tragjike për të tërhequr konsumatorë, gjë që qartazi është kundër vlerave themelore në të cilat mbështeten Shqipëria dhe BE-ja, konkretisht dinjiteti njerëzor, liria, barazia dhe solidariteti, parimet e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, ashtu siç janë shpallur në KDThBE. Në këto rrethana, shenja do të perceptohet si fyese jo vetëm në lidhje me viktimat e këtyre sulmeve dhe të afërmit e tyre, por edhe në lidhje me çdo person me nivele normale

		<i>ndjeshmërie dhe tolerance. Prandaj, shenja është në kundërshtim edhe me politikën publike edhe me parimet e pranuar të moralit.</i>
--	--	--

Në të kundërt, në rast se shenja, pavarësisht se i referohet një ngjarjeje tragjike të njohur, **thjesht përshkruan një rrethanë në atë mënyrë që nuk ka të ngjarë të shkaktojë fyerje, të banalizojë ose të përfitojë nga tragjedia, shenja nuk ka të ngjarë të konsiderohet në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit.**

E pranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “F” të DMT-së		
Shenja	Mallrat dhe shërbimet	Arsyetimi
	Klasa 41: Shërbime edukative	<i>Kombinimi i mesazhit “CHERNOBYL DISASTER EXPERIENCE” me elementin figurë të lidhur me “shërbimet edukative” i referohet qartazi katastrofës bërthamore në Çernobil në vitin 1986, por nuk do të perceptohet se banalizon ose përfiton nga kjo ngjarje tronditëse për të tërhequr konsumatorë. Përveç kësaj, duke konsideruar kohën që ka kaluar nga momenti i tragjedisë, ajo nuk do të perceptohet si fyese. Prandaj, shenja është e pranueshme sipas parimeve të pranuar të moralit.</i>

Në mënyrë të ngjashme, nëse mallrat dhe/ose shërbimet për të cilat është bërë aplikimi **synojnë të edukojnë, të kapërcejnë dhe/ose rritin ndërgjegjësimin** për tragjedinë dhe nuk përçojnë mesazhe fyese, shenja ka më pak gjasë të refuzohet sipas parimeve të pranuar të moralit.

E pranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “F” të DMT-së		
Shenja	Mallrat dhe shërbimet	Arsyetimi
COVID ARMY	Klasa 42: Hulumtimet shkencore	<i>Shenja e lidhur me shërbimet për të cilat është kryer aplikimi do të perceptohet si një përpjekje për të kapërcyer dhe rritur ndërgjegjësimin për pandeminë e COVID-19. Përveç kësaj, ajo nuk përmban mesazh fyese dhe/ose tronditës kundrejt një grupi të veçantë me qëllimin për të tërhequr vëmendjen e konsumatorëve. Prandaj, shenja është e pranueshme sipas parimeve të pranuar të moralit.</i>
	Klasa 41: Muzetë	<i>Elementet figurativë të shenjës tregojnë në plan të parë vagonin tipik hekurudhor që përdorej për transportin e të burgosurve dhe, në distancë, ndërtesat e kampit të shfarosjes, bashkë me elementin fjalë “HOLOCAUST”. Duke marrë në konsideratë shërbimet për të cilat është kryer aplikimi, të cilat synojnë edukimin e konsumatorëve dhe rritjen e ndërgjegjësimit të tyre, shenja ka konotacion simbolik dhe neutral, pa asnjë mesazh fyese ose tronditës. Prandaj, shenja nuk është në kundërshtim me parimet e pranuar të moralit.</i>

2.5.9 Shenjat që përmbajnë/lidhen me figura historike, simbole të BE-së ose simbole kombëtare dhe/ose personalitete shumë të nderuara

Ky grup përfshin, pa kufizim, shenja ku elementët fjalë ose figurë, ose kombinimi i tyre, përmbajnë dhe/ose lidhen me:

- figurat historike,
- figura që konsiderohen simbole kombëtare ose të BE-së, dhe/ose

- personalitete shumë të nderuara në të gjithë Shqipërinë ose në një pjesë të saj, në BE ose në një Shtet Anëtar të BE-së.

Në parim, këto shenja ka të ngjarë të refuzohen në bazë të **politikave publike dhe/ose parimeve të pranuarra të moralit** në rast se ato i referohen një figure historike që ka konotacion negativ (p.sh. Hitleri) dhe në rast se **nxitin dhe/ose lavdërojnë qartazi këtë figurë, pasi ato mund të lëndojnë ndjeshmërinë e një pjese të shoqërisë përkatëse dhe/ose mund të prekin një interes që Shqipëria, BE-ja dhe/ose Shteti Anëtar i BE-së në fjalë konsiderojnë se është themelor sipas sistemeve të tyre të parimeve dhe vlerave (p.sh. dinjiteti njerëzor dhe parimi i demokracisë).**

Për më tepër, **edhe përdorimi banal i shenjave me konotacion tejet pozitiv** (p.sh. simbolet kombëtare me vlerë shpirtërore dhe politike) **mund të perceptohet si fyes** sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së, kur ndjeshmëria e publikut për atë simbol është e lartë ⁽⁵⁴⁾.

E papranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së		
Shenja	Mallrat dhe shërbimet	Arsyetimi
NELSON MANDELA	Klasa 16: Letër higjienike	Rëndomtësia e mallrave për të cilat është bërë aplikimi e banalizon figurën historike të Nelson Mandelës, i cili mori Çmimin Nobel për Paqen sepse i dha fund regjimit të aparteidit në mënyrë paqësore dhe shtroi themelet për demokraci në Afrikën e Jugut. Është mungesë respekti ndaj nderimit të lartë që publiku në Shqipëri dhe në BE ka për figurën e tij. Për rrjedhojë, shenja duhet të refuzohet për shkak të parimeve të pranuarra të moralit .

Në të kundërt, kur shenja i referohet një figure historike që perceptohet se ka “konotacion pozitiv” (p.sh. Mahatma Gandi) dhe **nuk nxit ose lavdëron asnjë ide fyese që mund të shihet si tronditëse dhe/ose nuk prek një interes të cilin Shqipëria, BE-ja dhe/ose Shteti Anëtar i BE-së në fjalë konsiderojnë se është themelor në pajtim me sistemet e tyre të parimeve dhe vlerave**, shenja **nuk ka të ngjarë të refuzohet** sipas këtij neni.

E pranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së		
Shenja	Mallrat dhe shërbimet	Arsyetimi
	Klasa 41: Muzetë	Shenja përbëhet nga përfaqësimi i fytyrës së Mahatma Gandit, një figurë historike që perceptohet se ka konotacione pozitive. Në kombinim me shërbimin për të cilin është bërë aplikimi, shenja nuk nxit ose lavdëron asnjë ide fyese e cila mund të shihet si tronditëse dhe as nuk prek ndonjë interes themelor të Shqipërisë, BE-së dhe/ose një Shteti Anëtar të BE-së. Kështu, shenja e pranueshme sipas nenit 4, paragrafi 1, germa “f” të DMT-së .

SHTOJÇË

Burime ligjore potencialisht të rëndësishme që lidhen me lirinë e shprehjes

⁽⁵⁴⁾ Në çështjen “ATATURK” (vendimi i datës 17.09.2012, R 2613/2011-2) u konsiderua se përdorimi banal i shenjave me konotacion tejet të lartë pozitiv, si “ATATURK”-u, mund të jetë fyes sipas nenit 7, paragrafi 1, germa “f” të Rregullores së BE-së për Markat Tregtare (RrBEMT). “ATATURK”-u është simbol kombëtar me vlerë shpirtërore dhe politike për publikun e gjerë evropian me origjinë turke.